





**Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së  
Brendshme/ Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin  
në Komunitet**



Ky projekt u financua nga SIDA dhe vihet në zbatim nga SIPU në kuadër të Programit “Mbështetja e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/ Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet” (2012/2015)

Ky dokument është një raport studimor i përgatitur për Programin “Mbështetja e e Qeverisë Suedeze ndaj Ministrisë së Brendshme/ Policisë së Shtetit Shqiptar për Policimin në Komunitet”. Opinionet ose pikëpamjet e shprehura jo detyrimisht shprehin opinionet e vetë programit.



# STUDIM

## Partneritetet në Kontekstin e Policimit në Komunitet

Tiranë, Shtator 2013



## PËRMBAJTJA E LËNDËS

Indeksi i tabelave dhe shifrave .....	7
Lista a Akronimeve të përdorura .....	9
Mirënjohje .....	11
I. Përmbledhje Ekzekutive .....	13
II. Kuptimi i Policimit në Komunitet, Domosdoshmëria e Partneriteteve Funktionale dhe Qasja e Studimit .....	20
II.1. Policimi në Komunitet – Një Retrospektivë e Shkurtër dhe Tranzicioni në Praktikën Demokratike të Policimit .....	22
III. Harta dhe Gjendja e Partneriteteve (gjetjet dhe rekomandimet) .....	26
1. Partneriteti me publikun e gjerë .....	28
1.1. Gjetjet mbi gjendjen e partneritetit të policisë me publikun e gjerë .....	28
1.2. Rekomandime për Përmirësimin e Partneritetit me Publikun e Gjerë .....	34
2. Bashkëpunimi me Partnerë Privatë të Organizuar (Konsultimi dhe Partneriteti me OJF-të, Biznesin dhe Grupe të tjera të Interesit) .....	35
2.1. Gjetje për nivelin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve privatë të organizuar .....	35
2.2. Rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve privatë të organizuar .....	37

3.	Bashkëpunimi me Partnerë Shtetërorë – (Konsultimi dhe Partneriteti me Strukturat e Pushtetit Qendror dhe Vendor).....	38
3.1.	Gjetje për nivelin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve shtetërorë .....	38
3.2.	Rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve shtetërorë .....	40
4.	Strukturat.....	43
IV.	Referencat .....	44
V.	ANEKSET .....	46
1.	Shënime mbi metodologjinë .....	46
2.	Gjetjet kryesore nga puna në terren .....	47
2.1.	Rendi publik dhe ndërveprimi me policinë e shtetit në nivel qarku - përmbledhje e përgjithshme .....	47
2.2.	Kuadri i punës dhe strategjia e policimit në komunitet .....	50
2.3.	Bashkëpunimi dhe angazhimi me policinë e shtetit në qarqe .....	52
2.4.	Përmbledhje e Sugjerimeve të të Intervistuarve .....	59
3.	Plan veprim i propozuar për zbatimin e mekanizmit të partneritetit .....	61
4.	Tabelat kryesore të sondazhit .....	66
5.	Rastet Studimore .....	76
	Rasti i Kroacisë.....	76
	Rasti i Kosovës.....	78

## INDEKSI I TABELAVE DHE SHIFRAVE

Tabela 1.	<i>Perceptimi i qytetarëve mbi sigurinë</i> .....	48
Tabela 2.	<i>Shkalla e raportimit të rasteve në departamentin e policisë</i> .....	49
Tabela 3.	<i>Arsye për mos-raportim të një ngjarjeje në polici</i> .....	49
Tabela 4.	<i>Interesi për të hyrë në forcat e policisë</i> .....	50
Tabela 5.	<i>Gatishmëria për të bashkëpunuar me policinë</i> .....	53
Tabela 6.	<i>Rastet e takimeve me policinë lokale për arsye informimi</i> .....	53
Tabela 7.	<i>Përpjekjet e Policisë për ruajtjen e rendit publik dhe sigurisë në komunitet</i> .....	54
Tabela 8.	<i>Niveli i respektit ndaj policisë së shtetit</i> .....	54
Tabela 9.	<i>Mekanizmi i mbledhjes së mendimeve të komunitetit</i> .....	55
Tabela 10.	<i>Opinionimi mbi impaktin e mundshëm të mendimit të qytetarëve mbi punën e policisë së shtetit</i> .....	55
Tabela 11.	<i>Informacion mbi grupime apo organizata për rendin publik dhe sigurinë në komunitet</i> .....	56
Tabela 12.	<i>Perceptimi i qytetarëve mbi bashkëpunimin e policisë së shtetit me komunitetin</i> .....	57
Tabela 13.	<i>Gatishmëria për pjesëmarrje në grupime apo organizatat të krijuara për policimin në komunitet</i> ....	58





## LISTA A AKRONIMEVE TË PËRDORURA

ISPL	Instituti për Studime Publike & Ligjore
UNDP	United Nations Development Program
SSSR	Support to Security Sector Reform
PSH	Policia e Shtetit
SACP	Programi Mbështetja Suedeze për MB/PSH për Policimin në Komunitet
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
PIK	Plani Veprimi Kombëtar të Integruar
DPQ	Drejtoria e Përgjithshme e Qarkut
DPP	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë



## MIRËNJOHJE

Ky studim është rezultat i kontributit dhe pikëpamjeve të shumë aktorëve të cilët konsiderohen, ligjërisht (*ose janë praktikisht*), partnerë të Policisë së Shtetit (PSH) në përpjekjet e përbashkëta për ruajtjen e rendit dhe parandalimin e kriminalitetit.

Falënderimi ynë shkon, së pari, për të gjithë bashkëpunëtorët tanë nga radhët e Policisë së Shtetit, për përfaqësuesit e niveleve të ndryshme të qeverisjes vendore, për përfaqësuesit e njëjësive për të drejtat e fëmijëve në nivel qarku, të njëjësive për mbrojtjen e fëmijëve në nivel bashkie, për përfaqësuesit e zyra-ve rajonale të punësimit dhe atyre të zyrave lokale të punësimit në nivel bashkie, për përfaqësuesit e drejtorive rajonale të ndihmës ekonomike dhe shërbimit social dhe ata të seksioneve të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve sociale pranë bashkive, për përfaqësuesit e drejtorive rajonale arsimore dhe atyre në nivel bashkie, për përfaqësuesit e organizatave jo qeveritare, që punojnë në fusha të tilla si, të *drejtat e grave dhe të miturve, dhuna në familje, të drejtat e minoriteteve dhe të grupeve të marginalizuara, trafiqet, gjakmarrja* etj, si dhe për përfaqësuesit e biznesit të vogël dhe atij të mesëm, të cilët janë konsultuar në kuadrin e këtij studimi.

Një falënderim shkon edhe për ata përfaqësues të përzgjedhur të publikut të gjerë, të cilët bashkëpunuan me ekipin e ISPL për vjeljen e perceptimit të komunitetit mbi nivelin e ndërveprimit të tij (*komunitetit*) me policinë.

Një tjetër falënderim shkon për skuadrën që bëri punën në terren me përpikërinë dhe integritetin më të lartë profesional, për grumbullimin e të dhënave sasiore dhe cilësore, për përpunuesit e të dhënave, që i dhanë trajtë dhe kuptim morisë së të dhënave të grumbulluara, duke i kthyer ato në lëndë të parë për këtë studim të rëndësishëm.

Një falënderim i veçantë shkon për shkruarit e raportit, të cilët përkthyer të dhënat sasiore dhe cilësore në gjetje dhe rekomandime, që shpresojmë të ndikojnë në konceptimin e politikave dhe marrjen e vendimeve të informuara në fushën e policimit në komunitet.

Së fundi, një falënderim i posaçëm edhe për ekipin e Programit Mbështetja Suedeze ndaj MB/PSH për Policimin në Komunitet (SACP), për anëtarët e Komitetit Drejtues të Programit dhe ata të grupeve të punës, të cilët nuk e kursyen ndihmën dhe këshillat e tyre të çmuara gjatë gjithë periudhës së zbatimit të studimit.



## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky studim është kryer nga *Instituti për Studime Publike & Ligjore (ISPL)* në harkun kohor prill-shtator 2013, në kuadrin e një kontrate me *Programin Mbështetja Suedeze ndaj MB/PSH për Policimin* në Komunitet (*këtu e tutje, Programi SACP*)<sup>1</sup>.

Objektivi i studimit është të shqyrtojë në mënyrë kritike rrjetin e partneriteteve të policisë dhe, çka është më e rëndësishme, cilësinë e tyre (*të partneriteteve*).

Duke pasur parasysh se policimi në komunitet, më shumë sesa filozofi dhe strategji operacionale, është një gjendje fakti, dhe se kjo mënyrë policimi nuk është e mundur të ushtrohet, veçse përmes komunikimit me komunitetin, ky studim është konceptuar në mënyrë të tillë që të verifikojë ekzistencën dhe cilësinë e linjave të komunikimit midis policisë dhe partnerëve të saj natyrorë në ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike<sup>2</sup>.

Në vijim të gjetjeve mbi gjendjen e partneriteteve, studimi paraqet rekomandime mbi rrugët që mund të ndiqen për përmirësimin e partneriteteve aty ku ekzistojnë dhe krijimin e tyre aty ku nuk ekzistojnë ose janë në një gjendje fillestare. Rekomandimet i adresohen si Policisë së Shtetit (*PSH*), ashtu edhe *Programit SACP*, për të kalibruar ndërhyrjen e tij të asistencës në pjesën e mbetur të kohës së projektit.

Policimi në komunitet konsiderohet sot si një mënyrë që policia të bëjë më mirë detyrën e saj parësore për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike. Me fjalë të tjera, policimi në komunitet shënon një qasje të re, më të efektshme, për arritjen e objektivave të kahershëm të policimit. Nga ana tjetër, krijimi dhe mbarëvajtja e një marrëdhënieje partneriteti midis policisë dhe komunitetit, të cilit ajo i shërben është në themel të kësaj mënyre policimi. Sa më sipër, nuk është thjesht një vetëdije apo një praktikë e mirë pune për *PSH*. Krejt në të kundërt, skema e policimit, e skicuar në këto pak fjalë, është një skemë ligjore. Pra, policimi në komunitet është mënyra zyrtare e policimit që urdhëron ligji. Ky është kuadri konceptual brenda të cilit zhvillohet edhe ky studim.

---

1) Të dhënat mbi metodologjinë e përdorur do t'i gjeni në Pjesën II të këtij studimi.

2) Me fjalë të tjera, vetëm përmes ekzistencës dhe mirëfunksionimit të partneriteteve mund të bëhet realitet objektivi kryesor i këtij lloji policimi që është identifikimi i problemeve, i shkaqeve që qëndrojnë në themel të këtyre problemeve dhe, çka është më e rëndësishme, parandalimi i tyre.

Na rezulton se, Policia e Shtetit (PSH) ka një kuptim të qartë për llojin e partnerëve dhe rolin e secilit prej tyre në përpjekjen e përbashkët për të garantuar rend dhe siguri. PSH është, gjithashtu, e ndërgjegjshme për avantazhet praktike që sjell kjo mënyrë policimi, e cila ka në themel të saj komunikimin e vazhdueshëm me partnerët.

Nga ana tjetër, të vetëdijshëm për avantazhet e bashkëpunimit me policinë janë edhe partnerët e saj komunitarë dhe shtetërorë (*publiku i gjerë, organizatat e shoqërisë civile, komunitetet fetare, biznesi dhe strukturat e ndryshme të qeverisjes qendrore dhe vendore*).

E megjithatë, pavarësisht nga detyrimi i qartë ligjor për policinë dhe nga vetëdija e dyanshme e partnerëve, studimi arrin në përfundimin se, *sistemi i partneriteteve në kontekstin e policimit* në komunitet është jo funksional.

Duke pasur parasysh larminë dhe karakteristikat e partnerëve të PSH në ruajtjen e rendit dhe të sigurisë, gjetjet dhe rekomandimet kryesore të studimit, në lidhje me gjendjen e partneriteteve, janë të organizuara në 3(*tre*) grupe të mëdha, si më poshtë:

### *Përmbledhje e Gjetjeve dhe Rekomandimeve për Ndërveprimin e PSH me Komunitetin e Gjerë*

- Nuk mund të bëhet fjalë për një partneritet të mirëfilltë midis PSH dhe shoqërisë në tërësi, pasi ndërveprimi midis policisë dhe komunitetit të gjerë nuk është i strukturuar. Në kushtet e mungesës së forumeve ose grupeve të organizuara komunitare (*në bazë lagjeje, komune, njësie bashkiake ose ndonjë njësie tjetër për t'u përcaktuar*), të cilat do të ndihmonin policinë në identifikimin e problemeve dhe përcaktimin e përparësive të policimit, bashkëpunimi midis policisë dhe komunitetit të gjerë është sporadik dhe i njëanshëm<sup>3</sup>. Mënyra e vetme për të pasur një ndërveprim të strukturuar (*ose partneritet, sepse vetëm një ndërveprim i strukturuar meriton të quhet partneritet*) me komunitetin e gjerë është krijimi dhe funksionimi i strukturave komunitare të organizuara dhe permanente;
- Theksojmë se pilotimi i disa grupeve komunitare të organizuara dhe permanente është eksperimentuar në të shkuarën e afërt në Shqipëri, në kuadrin e Programit të UNDP, në Mbështetje të Reformës së Sektorit të Sigurisë (*prej këtu, Programi SSSR<sup>4</sup>*) në vitet 2004-2007. Programi SSSR krijoi dhe mbështeti gjatë kohëzgjatjes së tij 10 (*dhjetë*) grupe të tilla komunitare.

3) I njëanshëm në kuptimin që vetëm PSH ndërmerr sporadikisht ndonjë fushatë ndërgjegjësimi për çështje të ndryshme. Ndësa *feedback* nga publiku mungon tërësisht.

4) Akronimi në anglisht.

- Pavarësisht nga krijimi i këtyre forumeve komunitare dhe përfshirja e përkohshme e tyre në çështjet e policimit në zonat ku ato u krijuan, gjetjet e studimit për gjendjen reale dhe cilësinë e ndërveprimit midis komunitetit të gjerë dhe policisë tregojnë se rezultatet e arritura nuk kanë qenë të qëndrueshme, pasi strukturat komunitare të ngritura nga *Programi SSSR* nuk ekzistojnë më.
- Thënë sa më sipër, studimi arrin në përfundimin se, është jetike për partneritetin me komunitetin e gjerë, dhe më tej për suksesin e policimit në komunitet, që të bëhet i mundur krijimi ose përdorimi, aty ku ekzistojnë, i strukturave komunitare më të qëndrueshme, me të cilat policia të mund të komunikojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar.
- Në këtë nivel, studimi rekomandon që *Programi SACP* të pilotojë ndërtimin dhe funksionimin e, së paku, një forumi/grupi komunitar gjatë jetës së projektit, sipas modelit të krijuar nga *Programi SSSR*. Qëllimi i këtij pilotimi do të ishte rigjallërimi i një përvoje pozitive (*ndonëse me rezultate jo të qëndrueshme*) dhe kodifikimi i *know how-t*, për krijimin e forumeve të tilla në të ardhmen në formën e një *Manuali për Krijimin dhe Funksionimin e Forumeve Komunitare*;
- Gjithashtu, duke pasur parasysh mungesën e qëndrueshmërisë së forumeve komunitare të krijuara nga *Programi SSSR* dhe për të kompensuar mungesën e karakteristike të qëndrueshmërisë së këtyre strukturave, studimi sugjeron që *Programi SACP* të ndihmojë Policinë e Shtetit për të hyrë në marrëdhënie partneriteti me disa struktura hibride (*sa komunitare, aq edhe ligjore*) të krijuara nga ligjet “Për Sistemin Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ligji “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligji “Për Administrimin e Bashkëpronësisë në Ndërtesat e Banimit”. Fjala është për struktura të tilla si *Komisionet e Etikës dhe të Sjelljes nëpër shkolla, Këshillat e Prindërve, Këshillat e Mësuesve dhe Qeveritë e Nxënësve, Këshillat Studentore, Asambletë e Bashkëpronarëve dhe administratorët e banesave*.
- Strukturat e sipërpërmendura, pavarësisht se me natyrë komunitare, janë të krijuara me ligj. Si të tilla, ato janë më se të qëndrueshme (*ndonëse, për momentin, disa prej tyre nuk janë funksionale*). Ndërtimi i një partneriteti të efektshëm me këto forume hibride do të ndihmonte për të strukturuar në vazhdimësi marrëdhënien e policisë me publikun e gjerë. Me fjalë të tjera, rekomandohet që *Projekti SACP*, brenda kohëzgjatjes së tij, të ndihmojë Policinë e Shtetit në vendosjen e një partneriteti efektiv me këto struktura hibride komunitaro-ligjore.

- Pavarësisht se përvoja e *Programit SSSR* në vitet 2004 – 2007, tregoi se krijimi dhe funksionimi i grupeve/forumeve të organizuara komunitare në kuadrin e një projekti të asistencës së huaj nuk është një zgjidhje e qëndrueshme, si dhe duke llogaritur vështirësitë buxhetore dhe organizative që mund të hasen nga *PSH* në krijimin dhe funksionimin e vazhduar të këtyre forumeve, studimi sugjeron që *Programi SACP* të ndihmojë *PSH* që kjo e fundit të zhvillojë *know how* për ndërtimin e tyre (*forumeve të organizuara komunitare*) dhe ta aplikojë këtë *know how* në mënyrë *ad hoc* dhe të përsëritur sipas nevojave të diktuar nga gjendja e rendit dhe e sigurisë në njësi të ndryshme komunitare.
- Në këtë kuadër, Programi SACP mund të ndihmojë edhe në trajnimin dhe specializimin e një grupi oficerësh, të cilët do të vepronin pastaj si një “*skuađer ambulante*” për ndërtimin dhe mbarëvajtjen e forumeve komunitare *ad hoc* kudo që do të ishte e nevojshme.
- Përveç mungesës së grupeve/forumeve të organizuara komunitare, studimi identifikon si shkak për ndërveprimin e dobët dhe të pastrukturuar të *PSH* me komunitetin e gjerë edhe infrastrukturën e dobët pritëse në komisariate dhe në drejtoritë e policisë. Përsëri, kujtojmë se nevoja për përmirësimin e infrastrukturës pritëse është e njohur për *PSH* dhe se disa përpjekje serioze për adresimin e kësaj problematike janë ndërmarrë në të shkuarën, sidomos në kuadrin e *Programit SSSR*. Pavarësisht nga sa më sipër, vizitat e ekipit të *ISPL* nëpër qarqe tregojnë se ambientet pritëse, në të cilat *Programi SSSR* pati kryer investime, ose janë degraduar, ose e kanë humbur funksionin e tyre fillestar si qendra fokale të ndërveprimit me komunitetin<sup>5</sup>. Në këtë përfundim kemi arritur qoftë përmes vëzhgimit në vend të këtyre faciliteteve, qoftë përmes sondimit të perceptimit të qytetarëve dhe intervistave me aktorët kyç. Pra, edhe në këtë aspekt, produktet e asistencës ndërkombëtare kanë rezultuar jo të qëndrueshme.
- Studimi arrin në përfundimin se, degradimi i qendrave pritëse është shkaktuar sa nga ndërprerja e investimeve të mëtijshme në këto struktura, aq edhe nga zbehja e motivimit të *PSH* për të inkurajuar dhe mbajtur një ndërveprim intensiv me komunitetin. Një tjetër faktor që, mesa duket, ka përcaktuar zbehjen e funksioneve të këtyre ambienteve pritëse është edhe mungesa e trajnimeve të oficerëve relevantë për teknikat dhe praktikën e komunikimit me publikun.

---

5) Disa prej këtyre ambienteve kanë kaluar në përdorim të njësisive të pushtetit vendor.



- Në dritën e gjetjeve të mësipërme, si dhe të kushtëzuar nga nevoja për të siguruar qëndrueshmëri në produktet e asistencës, studimi sugjeron që *Programi SACP* të ndihmojë *PSH* në mënyrat e mëposhtme:
  - të ndihmojë në ndërtimin e një zyre model pritjeje (*të ngjashme me ato të ndërtuara nga SSSR*);
  - në mënyrë që të sigurojë qëndrueshmërinë e këtij rezultati, të ndihmojë në hartimin e një urdhri të Drejtorit të Përgjithshëm, i cili të fiksojë formatin dhe standardet teknike për çdo ndërhyrje të ardhme në ambientet pritëse të komisarivateve dhe të drejtorive të policisë;
  - të ndihmojë në hartimin e një *Manuali për Krijimin dhe Funksionimin e Forumeve Komunitare*;
  - të trajtojë një numër, për t’u përcaktuar, oficerësh, të cilët do të veprojnë si një “*skuadër ambulante*” për ndërtimin dhe mbarëvajtjen e forumeve komunitare *ad hoc* kudo që do të gjykohet e nevojshme nga *PSH*;
  - të ndërtojë një *Syllabus dhe një Manual* për trajnimin e oficerëve të policisë për teknikat dhe praktikën e komunikimit me publikun;
  - të trajtojë një numër, për t’u përcaktuar, oficerësh në teknikat dhe praktikën e komunikimit me publikun.

### ***Përmbledhje e Gjetjeve dhe Rekomandimeve për Ndërveprimin e PSH me Segmente të Organizuara të Komunitetit***

- Ndërsa është, deri diku, e kuptueshme vështirësia në strukturimin e marrëdhënieve me komunitetin e gjerë, përmes krijimit të forumeve komunitare të organizuara e permanente, ky problem nuk ekziston sa i takon bashkëpunimit me segmentet e organizuara të komunitetit (*OJF, Biznes etj*).
- Studimi konfirmon interesin e lartë të organizatave të shoqërisë civile që punojnë në fusha të tilla si, dhuna në familje, të drejtat e grave dhe të miturve, të drejtat e minoritetëve dhe grupeve të marginalizuara, trafiket, gjakmarrja etj, por edhe të disa segmenteve të biznesit, për të pasur një bashkëpunim efektiv me policinë;
- Çdo drejtori qarku duhet të ndërtojë një *datbazë* të plotë me emrat, adresat dhe pikat e kontaktit të organizatave jo qeveritare aktive në fusha të tilla si, dhuna në familje, të drejtat e grave dhe të

miturve, grupet e marginalizuara, trafiket, gjakmarrja etj, si dhe komunitetet fetare, organizatat e biznesit, sindikatat etj.

- Duke pasur parasysh edhe interesin e madh të këtyre organizatave (*sidomos të OJF-ve*) për bashkëpunim me policinë, i takon kësaj të fundit të marrë iniciativën dhe të bëjë realitet *ngritjen e struktura-ve permanente të konsultimit* më këto segmente të organizuara të komunitetit.
- Programi SACP duhet të ndihmojë Policinë e Shtetit që të organizojë këto forume brenda kohëzgjatjes së projektit.
- Po kështu, SACP mund të asistojë PSH në rishikimin kritik të rrejtësive të memorandumeve të bashkëpunimit që PSH ka lidhur me përfaqësues të këtij segmenti të komunitetit, si dhe në hartimin e një memorandumit tip mbi bazën e të cilit PSH duhet të rinegociojë të gjitha memorandumet ekzistuese.

### ***Përmbledhje e Gjetjeve dhe Rekomandimeve për Ndërveprimin e PSH me Partnerët Shtetërorë***

Partneriteti i policisë së shtetit me partnerët e saj shtetërorë funksionon në nivelin e zbatimit në praktikë të detyrave të përbashkëta në fushën e rendit dhe të sigurisë, por është inekzistent në nivel planifikues e strategjik.

Studimi arrin në përfundimin se, potenciali i këtij bashkëpunimi është shumë më i madh se kaq. Për të bërë të mundur përdorimin e plotë të këtij potenciali, studimi sugjeron 2 (*dy*) linja veprimi:

- të ngacmohet interesi i partnerëve shtetërorë për forma të reja bashkëpunimi me policinë;
- të formalizohet ligjërisht detyrimi i partnerëve shtetërorë për t'u përfshirë aktivisht në proceset e rëndësishme të planifikimit dhe monitorimit të policimit në komunitet.

Anketimi dhe hulumtimet cilësore, të kryera në kuadër të studimit, vënë dukje faktin se, rendi dhe siguria publike cenohen ose, të paktën, rrezikohen jo vetëm nga veprat penale dhe kundravajtjet administrative (*trajtimi i të cilave është qartësisht në sferën e kompetencave ose të policisë ose të partnerëve të tjerë shtetërorë, si pushteti vendor dhe inspektoriatet e shumta*), por edhe nga një kategori tjetër sjelljesh

hibride, të ashtuquajturat *sjellje anti - shoqërore*, të cilat jo vetëm që përbëjnë në vetvete shqetësim real për rendin dhe qetësinë publike, por përmbajnë edhe embrionin e veprave të ardhshme penale ose të kundravajtjeve të ardhshme administrative

Mbi bazën e përfundimeve të mësipërme, studimi sugjeron marrjen e masave të mëposhtme:

- Hartimi i një ligji të posaçëm për sjelljen anti shoqërore, i cili t'u japë policisë, pushtetit vendor dhe inspektoriateve të drejtën për të kërkuar nga gjykata lëshimin e urdhrave kufizues për kundravajtësit. Shkelja e urdhrit të konsiderohet kundravajtje penale;
- Ngritja e një komiteti koordinues për policimin në komunitet sipas modelit të krijuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 07.02.2011 "Për Mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij"

## II. KUPTIMI I POLICIMIT NË KOMUNITET, DOMOSDOSHMËRIA E PARTNERITETEVE FUNKSIONALE DHE QASJA E STUDIMIT

Duke filluar, së paku nga viti 2007<sup>6</sup>, Shqipëria i është bashkuar prirjes ndërkombëtare për adoptimin e policimit në komunitet, si një filozofi dhe metodë pune. Kjo qasje e re në veprimtarinë policore mendohet se plotëson mënyrën tradicionale të policimit, ku policia është tipikisht në pozita pritëse dhe reaguese. Me fjalë të tjera e të thjeshta, në thelb, policimi në komunitet konsiderohet sot si një mënyrë që policia të bëjë më mirë detyrën e saj parësore për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike.

Ndërsa objektivat e policimit mbeten gjithnjë ata që kanë qenë (*ruajtja e qetësisë dhe rendit publik, mbrojtja e të drejtave të qytetarëve, si dhe parandalimi dhe zbulimi i krimit*), policimi në komunitet shënon një qasje të re për arritjen e këtyre objektivave të kahershëm në mënyrë më të efektshme.

Nga ana tjetër, krijimi dhe mbarëvajtja e një marrëdhënieje partneriteti midis policisë dhe komunitetit të cilit ajo i shërben është në themel të kësaj mënyre policimi. Nuk mund të thuhet se ekziston diçka si policimi në komunitet përderisa nuk ekziston, apo nuk është në lartësinë e duhur partneriteti midis policisë dhe komunitetit. Jo më kot, Strategjia e Policisë së Shtetit 2007-2013 e përcakton policimin në komunitet si “*një model policimi ..... që përfshin publikun në arritjen e misionit të policisë*”.

Pavarësisht se policimi në komunitet, me të drejtë, konsiderohet si një policim më efikas, për të kuptuar nëse ai (*policimi në komunitet*) praktikohet apo jo si metodë pune, nga Policia e Shtetit nuk është aspak e nevojshme të analizosh efikasitetin e policimit në tërësi (*p.sh., duke parë tendencat në kriminalitet apo nivelin e zbulueshmërisë së tij*). Për të kuptuar nëse ky lloj policimi praktikohet apo jo, mjafton të analizohet gjendja e partneritetit apo niveli i bashkëpunimit të policisë me komunitetin.

Nga ana tjetër, mund të argumentohet se prania e marrëdhënieve të mira midis policisë dhe komunitetit nuk është domosdoshmërisht e baras vlefshme me policim më cilësor. Natyrisht që përmirësimi i aspekteve të tjera të punës së policisë si p.sh., trajnimi i vazhdueshëm, mirë-financimi, motivimi etj, ndikojnë ndjeshëm në cilësinë e policimit. Sidoqoftë, pa vënë në dyshim nevojën për përmirësim në të gjitha këto drejtime, ngritja dhe kultivimi i partneriteteve është një hap i parë e i domosdoshëm në drejtim të rritjes së cilësisë së policimit.

---

6) Në fakt filozofia e policimit në komunitet ne nivel strategjik është përqafuar që në vitin 2004.

Prandaj, qasja e këtij studimi është e tillë që, duke analizuar nivelin e bashkëpunimit/partneritetit, vetiu del në përfundime edhe për praktikimin e policimit në komunitet si metodë pune dhe, madje, edhe për cilësinë e policimit në këtë vend.

Me fjalë të tjera, të përpiqesh të kuptosh nëse policimi në këtë vend bëhet në mënyrë tradicionale e reaguese apo, në të kundërt, në mënyrë parandaluese dhe komunitare, është njëlloj si të kuptosh nëse policohet mirë apo keq. Në këtë kuptim, studimi ynë, ndonëse fokusohet tek partneritetet, mund të konsiderohet edhe si një studim bazë për efektivitetin e policimit në komunitet.

Në këtë kontekst dhe bazuar mbi premisën tashmë të gjithë pranuar se policimi nuk është detyrim vetëm i policisë, *Instituti për Studime Publike & Ligjore (ISPL)* është kontraktuar nga *Programi Mbështetja Suedeze ndaj MB/PSH për Policimin* në Komunitet për të shqyrtuar në mënyrë kritike hartën e partneriteteve të policisë dhe, çka është më e rëndësishme, cilësinë e tyre (*të partneriteteve*). Me fjalë të tjera, ky studim synon të verifikojë ekzistencën dhe cilësinë e linjave të komunikimit midis policisë dhe partnerëve të saj natyrorë.

Në vijim të gjetjeve mbi gjendjen e partneriteteve, studimi paraqet rekomandime mbi rrugët që mund të ndiqen për përmirësimin e partneriteteve aty ku ekzistojnë dhe krijimin e tyre aty ku nuk ekzistojnë ose janë në një gjendje fillestare.

Në një përpjekje për t'iu përgjigjur termave të referencës (*si më sipër*), *ISPL* ka kryer një hulumtim të gjithanshëm sasior dhe cilësor.

Në aspektin cilësor, duke mbajtur parasysh karakteristikat e gjithë pranuar të policimit në komunitet (*vizibiliteti, aksesueshmëria, përgjegjshmëria ndaj shqetësimeve të komunitetit, qasja parandaluese etj*), studimi ka shqyrtuar misionin, strukturat, procedurat standarde dhe planet e punës së drejtorive të policisë në qarqe në një përpjekje për të kuptuar nëse ato janë të përshtatshme për të mbështetur komunikimin/ndërveprimin e policisë me komunitetin. Metodatat e grumbullimit të të dhënave, për këtë pjesë të studimit, kanë qenë intervistat, vëzhgimet e drejtpërdrejta dhe shqyrtimi i dokumenteve zyrtare.

Ndërsa, në aspektin sasior, studimi ka hulumtuar perceptimet dhe përvojat e përfutuesve fundorë të shërbimit policor, në një përpjekje për të kuptuar se sa i përgjigjet policimi nevojave reale të komunitetit dhe sa ndërveprim ka midis policisë dhe komunitetit në procesin e ndërtimit të planeve të punës për policimin në komunitet. Metodat e grumbullimit të të dhënave për këtë pjesë të studimit ka qenë anketimi i publikut, me fokus të veçantë tek të rinjtë (*Për më shumë informacion në lidhje me metodën e studimit ju lutemi t'i referoheni pjesës II të këtij studimi*).

Mbi këtë bazë kemi arritur në përfundim se, në lidhje me gjendjen reale të partneritetit të Policisë së Shtetit me komunitetin si më poshtë:

## II.1. Policimi në Komunitet – Një Retrospektivë e Shkurtër dhe Tranzicioni në Praktikën Demokratike të Policimit

Fillimet e policisë së shtetit shqiptar datojnë në vitin 1913 së bashku me lindjen, disa muaj më parë, të shtetit të ri shqiptar. Akti i krijimit të forcave të rendit mban datën 13 janar 1913. Që nga ai çast, zhvillimi institucional i policisë së shtetit është karakterizuar nga ndërprerje të shumta, të shkaktuara nga kushtet e pa favorshme socio-politike, të brendshme e të jashtme, sidomos luftërat ballkanike dhe ato botërore.

Ballafaquar me mungesën akute të rendit dhe qetësisë publike në vend, reformat e pakta që u ndërmorën në atë kohë, me ndihmën e Holandës dhe Britanisë së Madhe, synonin thjesht ngritjen e një trupe policore funksionale.

Në periudhën midis dy luftërave (1920-1939), policia përfitoi nga një reformë bashkëkohore ligjore dhe organizative nën influencën e disa misioneve të huaja të asistencës (*kryesisht italiane dhe britanike*). Sidoqoftë, sa i takon filozofinë e policimit në këtë kohë duket se ajo ishte tërësisht tradicionale e reaguese, edhe pse në Britaninë e Madhe (*një nga vendet prej nga vinte asistencë teknike për policinë shqiptare*) në atë kohë kishte filluar të praktikoheshin ideja e një policimi më komunitar, që ndërvepron me komunitetin dhe përfiton prej tij.

Pas luftës së dytë botërore, mënyra e organizimit dhe misioni i policisë shqiptare u përputhën plotësisht me modelin sovjetik, ashtu si në të gjitha shtetet e tjera të ish bllokut lindor. Policimi në këtë periudhë ishte në thelb militarist dhe i orientuar funksionalisht drejt goditjes së çdo forme disidence në vend. Pavarësisht nga natyra represive e policimit në atë kohë, pikërisht për hir të rritjes së efektivitetit të këtij represioni, në Shqipërinë komuniste janë praktikuar disa forma të ndërveprimit me komunitetin të cilat, për hir të së vërtetës, kanë ndihmuar në efektivitetin e policimit pavarësisht përvetimit të misionit të policisë.

Në Shqipërinë komuniste, gjithnjë në kuadrin e modelit sovjetik, policia e shtetit komunikonte aktivisht me shoqërinë përmes një organizate të ashtuquajtur komunitare, frontit demokratik. Fronti demokratik ishte një organizatë me shtrirje kapilare, por që vepronte i organizuar në bazë lagjeje ose në bazë të ndonjë njësie tjetër administrative. Në përbërje të organizatave të frontit kishte banorë të lagjeve, të përzgjedhur nga partia komuniste, të cilët kishin njohuri të thella të përbërjes dhe problematikës shoqërore të lagjes. Ndonëse konsiderohej një organizatë shoqërore, fronti demokratik kishte një status gjysmë zyrtar, pasi strukturat, organizimi dhe funksionet e tij rregulloheshin me ligj. Me fjalë të tjera,

fronti demokratik, i cili konsiderohej si një gardian i moralit të komunitetit nga nomenklatura komuniste, kishte kompetenca të mirëfillta ligjore për trajtimin e sjelljeve anti shoqërore, të cilat nuk përbënin vepra penale.

Çështje tipike që gjykoreshin nga organizatat e frontit ishin *shkelje të disiplinës në punë, vjedhje të vogla të pasurisë shtetërore, shoqërore dhe private, dehja në publik, akte të vogla huliganizmi, prishje të qetësisë publike, sjellje të pahijshme, moskujdesja për të moshuarit dhe të miturit, përdorimi fjalëve të turpshme në publik, dëmtime të pronës së përbashkët dhe mosmarrëveshje të vogla pronësie, kur palët në konflikt binin dakord për juridiksionin e frontit, si dhe çdo sjellje tjetër anti-shoqërore që nuk përbënte vepër penale. Pas jehonës që pati në Shqipëri revolucioni kulturor kinez, kësaj liste iu shtuan edhe mbikëqyrja e të ashtuquajtura-ve “shfaqje të huaja”, antenat televizive të orientuara nga perëndimi etj.*

Sanksionet që aplikoheshin nga organizatat e frontit për shkeljet e treguara më lart përfshinin forma të tilla si, një *ndjesë publike, një paralajmërim, një rekomandim për largim nga puna ose transferim ose ulje në përgjegjësi e keqbërësit, rekomandim për largimin e një keqbërësi nga një banesë publike, rekomandime për largimin nga puna të një zyrtari publik etj.* Në llogari të fundit, organizatat e frontit mund edhe të transferonin një çështje të juridiksionit të tyre në gjykatë, kur vlerësonin se çështja nuk përbënte sjellje anti shoqërore, por një vepër penale të mirëfilltë.

Procedurat e veprimit të frontit ishit tejet jo formale, të shpejta dhe kishin si qëllim reformimin e keqbërësit dhe edukimin e komunitetit. Aktiviteti i organizatave të frontit zhvillohej në bashkëpunim të ngushtë me njësitë përkatëse të policisë, duke i ndihmuar këto të fundit në kryerjen e misionit të tyre. Kjo ishte një filozofi dhe një strategji organizative që e lejonte policinë të komunikonte efektshëm me komunitetin.

Paradoksalisht, pikërisht në kohën e represionit më të madh dhe të mohimit të lirive themelore të qytetarëve, duket se Shqipëria ka pasur një mekanizëm funksional partneriteti midis policisë dhe komunitetit, ndonëse ky partneritet është përdorur për qëllime të mbrapshta.

Tranzicioni i policisë shqiptare dhe i policimit drejt metodave demokratike të punës filloi në vitin 1990 me mbarimin e regjimit komunist. Vitet që pasuan, deri në shpërthimin e trazirave shoqërore të vitit 1997, nuk shënojnë ndonjë reformë domethënëse në drejtim të policimit në komunitet. Mund të thuhet se, për herë të parë, forma të këtij lloji policimi vërehen në programin e dorëzimit vullnetar të armëve të vogla dhe të lehta, i cili filloi në gusht të vitit 1997 dhe vazhdoi në një mënyrë apo tjetrën deri në gusht 2002. Gjatë gjithë periudhës së zbatimit të këtij programi ka pasur një përfshirje të konsiderueshme të shumë organizatave të shoqërisë civile, si dhe janë përdorur nga policia e shtetit mënyra

të ndryshme të ndërgjegjësimit të publikut. Për këtë arsye, ky proces mund të konsiderohet si “*dallëndyshja*” e parë e policimit në komunitet në Shqipëri.

Sidoqoftë, përpjekja më serioze për të instaluar policimin në komunitet në Shqipëri, si një filozofi dhe praktikë pune, është pa dyshim programi i UNDP në mbështetje të reformave në sektorin e sigurisë (*Programi SSSR*), i zhvilluar në harkun kohor 2004 - 2007. *Programi SSSR* ndërmori një qasje holistike tek policimi në komunitet, duke konceptuar dhe zbatuar aktivitete që fokusoheshin sa tek policia, aq edhe tek komuniteti i gjerë.

Sa i takon grupit të parë të aktiviteteve (*atyre të fokusuara tek policia*), *Programi SSSR* ndërmori një sërë trajnimesh, si me oficerët e terrenit, ashtu edhe ata në nivel menaxhues mbi parimet dhe praktikat e policimit në komunitet. Në po këtë drejtim, *Programi SSSR* investoi në ndërtimin ose përmirësimin fizik të 9 (*nëntë*) sallave të pritjes në komisaritet e policisë, me besimin se infrastruktura fizike do të ndikonte në bashkëveprimin midis policisë dhe komunitetit.

Jo vetëm kaq, por *Programi SSSR* ndërtoi edhe zyra të vogla nëpër lagje, në të cilat banorët mund të takonin dhe komunikonin me inspektorin e rendit publik për lagjen.

Sa i takon grupit të dytë të aktiviteteve (*atyre të fokusuara tek komuniteti*), programi krijoi 10 (*dhjetë*) forume komunitare, të cilat ishin në kontakt të vazhdueshëm me inspektorët përkatës të policisë nëpër zona. Kjo praktikë pune u mbështet edhe nga disa grante të vogla. SSSR, gjithashtu, mbështeti një program vizitash të oficerëve të policisë nëpër shkolla dhe fushata ndërgjegjësimi në media për probleme të rendit dhe sigurisë dhe për nevojën e bashkëpunimit midis policisë dhe komunitetit.

Mbi bazën e trashëgimisë së lënë nga *Programi SSSR*, duke filluar nga viti 2007, Shqipëria i është bashkuar zyrtarisht prirjes ndërkombëtare për adoptimin e policimit në komunitet si një filozofi dhe metodë pune. Në fakt, për policimin në komunitet tashmë ekziston autorizimi ligjor (*neni 122 i ligjit nr. 79749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”*), orientimi strategjik (*Strategjia e Policisë së Shtetit 2007 - 2013*), plani konkret i punës (*Plani i Veprimit Operacional 2008-2010 për Implementimin e Policimit në Komunitet*), procedurat standarde përkatëse (*Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1417, 11.12.2009 Manuali i Procedurave Standarde për Rendin dhe Sigurinë Publike*) dhe strategjitë vjetore të policimit në nivel qarqesh.

Shfaqjet më të qarta të adoptimit të policimit në komunitet, si model i policimit nga *PSH*, mund të gjenden në disa drejtime. Kështu, p.sh., neni 12 i Ligjit Për Policinë e Shtetit e detyron *PSH* që të zhvillojë konsultime me partnerët e niveleve të ndryshme në procesin e hartimit të strategjive policore në nivel qarqu. Po kështu, policimi në komunitet është një parim që përshkon të gjithë strategjinë 7 (*shtatë*) vjeçare të *PSH*, e cila përbëhet nga 6 (*gjashtë*) elementë: parandalimi i krimit, zgjidhja e problemeve,



partneriteti, policim i udhëhequr nga informacioni, policim i udhëhequr nga planifikimi strategjik dhe nga kostot. Strategjia e vë theksin tek “identifikimi dhe zgjidhja e problemeve, vizibiliteti dhe aksesimi i qytetarëve tek shërbimet policore dhe cilësia e këtyre shërbimeve”.

Së fundi, policimit në komunitet i dedikohet edhe një plan veprimi për vitet 2011-2013, i cili identifikon një sërë objektivash e veprimtarish në këtë fushë.

Në rrafshin organizativ, inspektorët e zonës janë ata oficerë të policisë të cilët janë zbatuesit e drejtpërdrejtë të policimit në komunitet, pasi ata janë në kontakt të vazhdueshëm me komunitetet dhe strukturat e qeverisjes vendore.

Natyrisht që policimi në komunitet, më shumë sesa strategji zyrtare, është një gjendje fakti. Në mënyrë që policimi në komunitet të bëhet realitet, është e domosdoshme që midis policisë dhe partnerëve të saj të ekzistojnë linja të qarta dhe të hapura komunikimi. Vetëm kështu mund të bëhet realitet objektivi kryesor i këtij lloji policimi, që është identifikimi i problemeve, i shkaqeve që qëndrojnë në themel të këtyre problemeve dhe, çka është më e rëndësishme, parandalimi i tyre.

Të vetëdijshëm për rëndësinë e mirëfunksionimit të partneriteteve, ky studim merr përsipër pikërisht të analizojë gjendjen e tyre.

### III. HARTA DHE GJENDJA E PARTNERITETEVE (GJETJET DHE REKOMANDIMET)

Siç u theksua më lart, ky nuk është një studim për efikasitetin e policimit në komunitet (*aq më pak, një diskutim për efikasitetin e policimit në përgjithësi*)<sup>7</sup> apo për diskutimin e meritave të kësaj qasjeje tek policimi. Adoptimi i policimit në komunitet si filozofi dhe praktikë pune për ruajtjen e rendit dhe qetësisë në Shqipëri është tashmë jashtë çdo diskutimi.

Në fakt, për policimin në komunitet tashmë ekziston autorizimi ligjor (*neni 122 i ligjit nr. 79749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit"*), orientimi strategjik (*Strategjia e Policisë së shtetit 2007-2013*), plani konkret i punës (*Plani i Veprimit Operacional 2008- 2010 për Implementimin e Policimit në Komunitet*), procedurat standarde përkatëse (*Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1417, 11.12.2009 Manuali i Procedurave Standarde për Rendin dhe Sigurinë Publike*) dhe programet vjetore të punës në nivel qarqesh.

Është e qartë se nuk mund të bëhet fjalë për një *tabula rasa*. Krejt në të kundërtën, dokumentet e sipërpërmendur dhe, në një farë mase, disa aspekte praktike të punës së policisë, të cilat i kemi hasur gjatë studimit, flasin për një farë maturimi të policimit në komunitet si botëkuptim (*ndonëse, për fat të keq, ende nuk mund të thuhet e njëjta gjë për shndërrimin e këtij botëkuptimi në rutinë pune*).

Mbi këtë bazë, duke prezumuar se bashkëpunimi me komunitetin është premisë absolute për policimin në komunitet, dhe që kjo mënyrë policimi është mënyra më e mirë për të policuar, studimi ynë është përqendruar tek shqyrtimi dhe analizimi i cilësisë së marrëdhënieve (*apo të partneritetit*) midis policisë së shtetit dhe komunitetit.

Na rezulton se, Policia e Shtetit ka një kuptim të qartë për llojin e partnerëve dhe rolin e secilit në policim. Ky përfundim na rezulton qoftë nga konsultimi i dokumenteve bazë të punës së policisë në këtë rrafsh<sup>8</sup>, qoftë nga bisedat gjysmë të strukturuar e të shumta me përfaqësues të policisë të të gjitha niveleve.

7) Po të ishte i tillë do të kishim ndjekur një metodë krejt të ndryshme. Për shembull do të kishim vëzhguar në mënyrë të drejtpërdrejtë punën e patrullave dhe karakteristikat e punës së tyre, do kishim analizuar përshkrimin e detyrave të inspektorit të zonës dhe zbatimin e tyre, do kishim vëzhguar mënyrën e punës së centralit ku priten ankesat e publikut, mënyrën e ndërtimit të programeve të punës për policimin në komunitet etj. Por siç e thamë më sipër nuk është ky qëllimi i këtij studimi.

8) Strategjia e Policisë së Shtetit 2007 - 2013, Plani i Veprimit Operacional 2008 - 2010 për Implementimin e Policimit në Komunitet, Urdhëri i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 1417, 11.12.2009 Manuali i Procedurave Standarde për Rendin dhe Sigurinë Publike, dhe strategjitë vjetore të sigurisë dhe policimit në komunitet për çdo qark.

Siç përcaktohet në dokumentet e lartpërmendura, harta e partneriteteve përfshin 3 (tre) nivele:

1. *Partnerët Shtetërorë;*
2. *Partnerë Privatë të Organizuar* (organizata të shoqërisë civile, grupime të biznesit dhe grupe të tjera interesi) dhe;
3. *Komuniteti i Gjerë.*

Përpara se të raportojmë gjetjet e studimit në lidhje me gjendjen dhe funksionimin e linjave të komunikimit me secilin nga grupet e lartpërmendura të partnerëve, e quajmë me vend të bëjmë një karakterizim të përgjithshëm të secilit prej këtyre grupeve, duke filluar nga ky i fundit.

Për arsye objektive, tipari kryesor i marrëdhënies midis policisë dhe komunitetit të gjerë është një lloj njëanshmërie, duke qenë së i takon policisë të gjejë një mënyrë për ta përfshirë komunitetin në çështjet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë. Puna e policisë në këtë drejtim vështirësohet nga fakti se *komuniteti i gjerë* nuk është i strukturuar dhe, për pasojë, paraqet disa vështirësi të posaçme sa i takon nevojës për të ngritur dhe mbarëvajtur një partneritet funksional me të.

Nga ana tjetër, marrëdhënia me *partnerët privatë të organizuar* (organizata të shoqërisë civile, grupime të biznesit dhe grupe të tjera interesi) karakterizohet përsëri nga një njëanshmëri, vetëm se kësaj radhe me kahe të kundërt. Na rezulton se policia është tipikisht në pozita pritëse e reaguese në ndërveprimin me këtë segment të komunitetit. Janë këto organizata (*sidomos OJF-të e specilizuara në fusha të tilla si, dhuna në familje, gjakmarrja, trafiqet dhe të drejta grave e të të miturve*) që i japin tonin kësaj marrëdhënieje dhe prirjen ta shfrytëzojnë partneritetin me policinë kryesisht për nevojat e tyre.

Së fundi, në lidhje me *partnerët shtetërorë* vlen të theksohet se bashkëpunimi i tyre me policinë është funksional, për aq sa i takon kryerjes në nivel praktik të detyrave të përbashkëta në fushën e rendit dhe të sigurisë publike. Po kështu, bashkëpunimi funksionon edhe në ato fusha të tjera ku ndihma e policisë gjykohet e nevojshme për kryerjen e detyrave ligjore nga partnerët e tjerë shtetërorë (*pushteti vendor, drejtoritë në qarqe dhe inspektoriatet e ndryshme*). Sidoqoftë, bashkëpunimi në nivel strategjik është inekzistent. Kjo duket më së miri në përfshirjen minimale dhe formale të partnerëve shtetërorë në procesin e hartimit dhe të zbatimit të strategjive vjetore në nivel qarku për policimin në komunitet. Për sa kohë mungon bashkëpunimi në këtë nivel, nuk mund të bëhet fjalë për një partneritet të vërtetë.

Në vijim do të trajtojmë në detaj rezultatet e analizës sonë, në lidhje me gjendjen dhe mënyrën e funksionimit të linjave të komunikimit midis policisë dhe segmenteve të mësipërm të komunitetit:

## 1. Partneriteti me publikun e gjerë

### 1.1. Gjetjet mbi gjendjen e partneritetit të policisë me publikun e gjerë

Ndonëse një entitet disi abstrakt, komuniteti i gjerë mbetet përfituesi kryesor i shërbimeve të policisë për garantimin e rendit dhe sigurisë publike. Në fund të fundit, policimi, si veprimtari e organizuar dhe e specializuar shtetërore për ruajtjen e rendit dhe të qetësisë publike, synon mbrojtjen e jetës dhe pasurisë së anëtarëve të komunitetit, mbrojtjen e të drejtave të tjera të tyre, si dhe zbulimin dhe parandalimin e krimit që i kërcënohet çdo anëtar individual të komunitetit. Në këtë kuptim, nuk është e vështirë të imagjinohet (*dhe kjo konfirmohet, në fakt, edhe nga gjetjet e anketimit me publikun e gjerë*), se komuniteti mbetet thellësisht i interesuar për bashkëpunim të efektshëm me policinë.

Në anën tjetër, tashmë është e qartë se një partneritet/komunikim efikas i shërben po aq edhe policisë, teksa e mundëson këtë të fundit të planifikojë, të orientojë dhe alokojë burimet (*gjithnjë të tendosura*), dhe, në fund të fundit, të bëjë detyrën, duke parandaluar kryerjen e veprave shoqërisht të rrezikshme.

Rezultatet e studimit, gjithashtu, konfirmojnë se të dyja palët janë më se të ndërgjegjshme për përfitim reciprok të kësaj marrëdhënieje. Sidoqoftë, gjetjet e studimit për gjendjen reale dhe cilësinë e ndërveprimit midis komunitetit të gjerë dhe policisë nuk janë shumë optimiste. Ndërsa interesi dhe gatishmëria e qytetarëve për bashkëpunim me policinë rezulton në nivele të larta (51% e të anketuarve e pohojnë këtë), shkalla e përfshirjes së tyre në çështjet e policimit mbetet e ulët (85% e anëtarëve të publikut të anketuar tregojnë se nuk janë konsultuar në ndonjë farë mënyre në lidhje me shqetësimet që interesojnë komunitetin e tyre apo informuar për punën e policisë). Kjo është një çarje serioze që duhet adresuar nga reformat e mëtejshme në fushën e policimit në komunitet.

Çfarë e përcakton këtë nivel të ulët të përfshirjes së komunitetit në çështje të policimit?

Siç u përmend edhe më lart, bashkëpunimi i policisë me komunitetin e gjerë karakterizohet nga vështirësia objektive që ky i fundit nuk është i strukturuar. Ky fakt, objektivisht, vështirëson komunikimin e dyanshëm, duke qenë se, siç pohojnë edhe përfaqësuesit e intervistuar të policisë së shtetit, nuk ekzistojnë interlokutorë të paracaktuar në anën e publikut të gjerë.

Në një përpjekje për t'i dhënë përgjigje pyetjes së shtruar më lart (*pse komuniteti nuk është i përfshirë sa duhet në çështjet e policimit?*), theksojmë se, përveç ekzistencës së linjave reale të komunikimit, si

kushte *makro* për ekzistencën dhe mirëfunksionimin e partneritetit midis Policisë së Shtetit dhe komunitetit të gjerë, duhen konsideruar edhe *cilësia e shërbimit* që ofron policia, *besimi i publikut* tek policia dhe *transparenca* në punën e policisë. Në analizën e mëposhtme jemi përpjekur të izolojmë veprimin e këtyre faktorëve të tjera (*cilësia, besimi dhe transparenca*) dhe jemi përqendruar vetëm në një faktor: *ekzistencën dhe funksionalitetin e linjave të komunikimit midis policisë dhe komunitetit të gjerë*.

Na rezulton se, nuk mund të ketë partneritet të mirëfilltë me një masë amorfe dhe heterogjene si komuniteti i gjerë për sa kohë që policia (*e vetmja palë e organizuar në këtë transaksion*) nuk ndërmerr hapa aktivë në drejtim të përfshirjes së komunitetit në policim.

Duhet theksuar në këtë pikë se, pavarësisht se rëndom në këtë studim, do të përdorim togfjalëshin *partneritet midis policisë dhe publikut të gjerë*, në fakt, kjo marrëdhënie nuk është dhe nuk mund të jetë një partneritet i mirëfilltë, të paktën në nivelin e ndërveprimit praktik midis dy palëve. Ndonëse nuk ka asnjë dyshim se, në nivel strategjik e taktik, policia përfiton nga bashkëpunimi me publikun e gjerë dhe, në këtë kuptim, marrëdhënia mes tyre është një partneritet i vërtetë, në nivelin e ndërveprimit praktik marrëdhënia mes tyre nuk mund të jetë veçse e njëanshme.

Thënë ndryshe, pavarësisht nga interesi gjenuin e i dyanshëm, marrëdhënia/partneriteti i komunitetit të gjerë me policinë tipikisht udhëhiqet nga kjo e fundit dhe konsiston në forma të tilla si, *ndërgjegjësimi* i qytetarëve për rreziqet që i kanosen rendit dhe sigurisë, *informimi* për rolin e tyre në drejtim të ruajtjes së rendit, adoptimi i metodave të punës që lehtësojnë në maksimum *raportimet* e qytetarëve, ndërmarrja e *veprimeve simbolike* si pjesëmarrja në aktivitete komunitare etj.

Në fakt, këto forma të përfshirjes së komunitetit të gjerë në veprimtarinë e Policisë së Shtetit njihen dhe praktikohen në një farë mase nga policia. Kështu, *Procedurat Standarde për Rendin dhe Sigurinë Publike*, në kapitullin që i referohet ndërtimit të partneriteteve, parashikojnë përdorimin e programeve të tilla si:

- Nxitja dhe edukimi i vullnetarizmit të publikut;
- Programet e përbashkëta polici - komunitet për mbrojtjen e zonave të banuara;
- Ndërtimi i grupeve të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të komunitetit;
- Takime të planifikuara dhe sistematike me banorët;
- Aktivitete të përbashkëta argëtimi me të rinjtë në lagjet e banimit;
- Vendosja e zyrave të pritjes së publikut etj.

Në vijim, strategjitë vjetore të sigurisë dhe policimit në komunitet për çdo qark planifikojnë dhe, ndonjëherë, raportojnë, kryerjen e veprimtarive të këtij lloji si p.sh.:

- Identifikimi i shqetësimeve të komunitetit;
- organizimi i, ose pjesëmarrja në, aktivitete të komunitetit (*p.sh., zhvillimi i festimeve për 100 vjetorin e Policisë së Shtetit*);
- takime me komunitetin;
- informimi i komunitetit në vazhdimësi për punën e policisë;
- llogaridhënie publike para komunitetit;
- organizimi i ditëve/javëve të hapura në ambientet e komisariateve;
- përgatitja dhe shpërndarja e fletëpalosjeve dhe spoteve publicitare për ndërgjegjësimin e publikut për çështje të ndryshme, etj.

Disa nga strategjitë vjetore të drejtorive të policisë në qarqe parashikojnë si aktivitete edhe *monitorimin e realizimit të objektivave* relevantë për përfshirjen e komunitetit në policim, duke përfshirë, madje, në ndonjë rast, edhe disa tregues të realizimit.

Në qoftë se analiza jonë do të ndalej në këtë pikë, mund të arrinim në përfundimin e nxituar se, përfshirja e komunitetit të gjerë në policim, përveçse doktrinë zyrtare, është tashmë një praktikë e konsoliduar pune në Policinë e Shtetit. Pa vënë në dyshim zbatimin e aktiviteteve të sipërpërmendura nga drejtoritë e policisë në qarqe (*nuk ka qenë ky fokusi i studimit tonë*), mbetet fakti kokëfortë që 85% e anëtarëve të publikut të anketuar tregojnë se nuk janë konsultuar në ndonjë farë mënyre në lidhje me shqetësimet që interesojnë komunitetin e tyre. Po kështu, ata pohojnë se nuk janë të informuar sa duhet për punën e policisë. Me fjalë të tjera, pavarësisht nga veprimtaria e raportuar nga Policia e Shtetit, publiku percepton se nuk është i përfshirë *sa dhe si duhet* në çështjet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë (*për më shumë detaje, shih gjetjet kryesore të anketimit më poshtë*).

Mendojmë se kjo është një gjetje e një rëndësie themelore për nivelin e komunikimit dhe ndërveprimit midis policisë dhe komunitetit të gjerë dhe, si e tillë, nuk mund të neglizhohet. Nuk do ishte ide e mirë që ajo (*gjetja*) të skartohej, si të ishte thjesht një perceptim i komunitetit pa ndonjë bazë reale. Edhe sikur vërtetë të ishte kështu, objektivisht ky perceptim ndikon drejtpërdrejt në besimin e komunitetit tek policia, i cili, nga ana tjetër, është parakusht për cilësinë e policimit në këtë vend.

Studimi sugjeron se problemet që qëndrojnë në themel të kësaj gjendjeje (*perceptimi se komuniteti nuk është përfshirë sa dhe si duhet në çështjet e ruajtjes së rendit dhe qetësisë publike*) mund të grupohen në 3 (tre) nivele si më poshtë:

*Problemet në zbatim* – në një vështrim krahasues<sup>9</sup>, mund të thuhet se metodat e punës të parashikuara në procedurat standarde për përfshirjen e komunitetit të gjerë në çështjet e policimit janë *shteruese* dhe të *sprovuara*, për sa i takon efektivitetit. Përderisa, përkundrejt përdorimit të këtyre metodave të sprovuara komuniteti, vazhdon të ndihet i papërfshirë në identifikimin e shqetësimeve dhe i painformuar për punën e policisë, deduktojmë se puna çalon në zbatimin e metodave të sipërpërmendura. Përsërisim se nuk ka qenë në fokusin e këtij studimi verifikimi i zbatimit të masave të parashikuara për përfshirjen e komunitetit në strategjitë vjetore të policimit. Megjithatë, nisur nga suksesi i kufizuar i këtyre metodave, gjykojmë se duhet të kërkohen rrugë dhe mënyra të tjera për rritjen e efektivitetit të tyre.

*Probleme në identifikimin e interlokutorëve* – Siç argumentuam më lart, marrëdhënia dhe komunikimi i policisë me komunitetin e gjerë priren të jetë të njëanshëm. Kjo marrëdhënie tipikisht ka kahen nga policia tek publiku i gjerë dhe ngjason më shumë me një veprimtari për ndërgjegjësimin e publikut, sesa me një ndërveprim real me të. Kjo për arsye objektive. Sidoqoftë, policia duhet të kërkojë, për aq sa është e mundur, rrugë dhe mënyra për të identifikuar interlokutorë formalë dhe të besueshëm në dialogun e saj me komunitetin e gjerë.

Studimi dallon potencial të veçantë në këtë drejtim në përdorimin e 3 (tre) ligjeve të cilat, për nga fusha e veprimit, adresojnë segmente të gjera të komunitetit dhe që krijojnë disa struktura relativisht të qëndrueshme me natyrë komunitare. Sugjerohet që policia të formalizojë kontaktet me këto struktura hibride, sa komunitare, aq edhe ligjore, dhe t'i përdori ato si interlokutorë në komunikimin me publikun e gjerë.

Kështu, p.sh., Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” urdhëron krijimin e disa strukturave me natyrë komunitare, të cilat mund të përdoren nga policia si interlokutorë në dialogun me një segment të rëndësishëm të komunitetit të gjerë që përfshin të miturit nga 5 – 18 vjeç dhe prindërit e tyre. Strukturat e krijuara nga ligji në fjalë, të cilat kanë në përbërje të tyre mësues, prindër dhe nxënës janë: *Komisionet e Etikës dhe të Sjelljes, Këshillat e Prindërve, Këshillat e Mësuesve dhe Qeveritë e Nxënësve*.

Po kështu, Ligji Nr. 9741, datë 21.5.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” krijon një tjetër strukturë me natyrë komunitare, *Këshillat Studentore*, në kuadër të çdo institucioni të arsimit të lartë. Edhe këtu duhet kërkuar vendosja e një partneriteti funksional.

---

9) Studimi i është referuar praktikave relevante të policimit komunitar në disa vende me fokus të veçantë në modelin e Kosovës dhe Kroacisë.

Së fundmi, Ligji Nr. 10112, datë 9.4.2009 “Për Administrimin e Bashkëpronësisë në Ndërtesat e Banimit” detyron krijimin e Asambleve të Bashkëpronarëve (një organizëm krejtësisht komunitar), si dhe funksionin e detyruar të administratorit për çdo objekt banimi të regjistruar zyrtarisht në njësitë e qeverisjes vendore.

Përfshirja e këtyre organizmave shoqërorë/komunitarë, por të krijuar me ligj, në aktivitetet që synojnë angazhimin e komunitetit të gjerë në çështjet e policimit do të kompensonte në një farë mase vështirësinë objektive që ndeshet kur kërkohet mbarëvajtja e ndërveprimit me një entitet të papërcaktuar dhe të papërfaqësuar si komuniteti i gjerë.

Një kundër-argument, në këtë pikë, mund të ishte fakti se këto struktura komunitaro – ligjore nuk janë ende funksionale (*sidomos, asambletë e bashkëpronarëve*) dhe, për pasojë, partneriteti me to nuk do të sillte ndonjë avantazh të dukshëm për ndërveprimin e policisë me komunitetin e gjerë. Sidoqoftë, presioni për funksionimin real të këtyre organizmave do të jetë në rritje dhe për këtë arsye Policia e Shtetit duhet të përpiqet të sigurojë avantazhe maksimale nga mundësitë që ofrojnë ato për strukturimin e dialogut me publikun e gjerë.

Natyrisht që identifikimi i disa interlokutorëve, që pritet të strukturojë disi ndërveprimin e policisë me komunitetin e gjerë nuk mundet kurrësi të zbehë format tradicionale të komunikimit dhe ndërgjegjësimit të njëanshëm nga policia tek publiku. Përkundrazi, kjo mënyrë komunikimi duhet të ngrihet në një nivel të ri cilësor.

*Probleme në cilësinë e planifikimit dhe raportimit* – Përfshirja e komunitetit të gjerë në çështjet e rendit dhe të sigurisë është një detyrim ligjor për Policinë e Shtetit. Për më tepër, siç u përmend edhe më lart, Policia e Shtetit ka adoptuar tashmë procedura standarde dhe plane rajonale veprimi, të cilat synojnë, midis të tjerash, të bëjnë të mundur përfshirjen reale të komunitetit të gjerë në çështjet e ruajtjes së rendit dhe sigurisë.

Sidoqoftë, gjetjet e anketimeve dhe vlerësimi formal i proceseve dhe dokumentacionit, sugjerojnë se *planifikimi i objektivave në fushën e policimit* në komunitet dhe raportimi i rezultateve është *defektoz*. Problemi kryesor, i identifikuar nga studimi në këtë pikë, është fakti se, tipikisht, planifikimi i objektivave në fushën e policimit në komunitet nuk bëhet në kuadrin e një dokumenti të posaçëm, por inkua drohet në të njëjtin dokument me objektivat e përgjithshëm të policimit në qark.

Në favor të shkrirjes së objektivave të policimit në komunitet në një dokument të vetëm me objektivat e përgjithshëm të policimit nëpër qarqe, mund të argumentohet se policimi në komunitet është thjesht një qasje tek veprimtaria e zakonshme policore dhe jo ndonjë veprimtari e veçantë. Kjo është e vërtetë. Megjithatë, gjykojmë se objektivat në fushën e policimit në komunitet meritojnë të trajtohen veçmas për disa arsye:



*Së pari*, për nga natyra e tyre, objektivat në fushën e policimit në komunitet kanë të bëjnë kryesisht me metoda pune ose rregullime organizative, të cilat mendohet se janë mbështetëse për kryerjen e detyrave bazë të policisë. Si të tilla, ato do të rrinin natyrshëm në një dokument më vete;

*Së dyti*, natyra e këtyre objektiveve, e përshkruar më lart, paracakton edhe natyrën e aktiviteteve dhe të treguesve, si dhe teknikat e monitorimit të zbatimit të tyre. Ky është një tjetër faktor që justifikon trajtimin veçmas të angazhimeve në këtë fushë.

*Së treti*, trajtimi i tyre në mënyrë të veçuar do të garantonte një nivel më të lartë të vëmendjes dhe të publicitetit tek ky problem, duke qenë se nuk do të ishte më i nevojshëm klasifikimi i këtyre dokumenteve (*sot strategjitë e policimit në drejtoritë e qarqeve janë dokumente me qarkullim të kufizuar*);

*Së fundi*, trajtimi veçmas i këtyre çështjeve do të ndihmojë edhe për të planifikuar e raportuar në mënyrë më profesionale dhe transparente për çështjet e policimit në komunitet, si dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për këtë mënyrë policiimi.

Një tjetër problem që lidhet me planifikimin e objektiveve dhe aktiviteteve në fushën e policimit në komunitet është *mungesa e standardizimit në planet e veprimit nga një qark në tjetrin*. Kjo vështirëson krahasimin e dokumenteve përkatës dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Po kështu, *deficitare është edhe teknika e formulimit të objektivave, aktiviteteve dhe treguesve*. Treguesit për realizimin e aktiviteteve komunitare, shpesh, mungojnë krejtësisht. Në ato raste, kur strategjitë rajonale përfshijnë tregues të zbatimit të tillë, si numri i telefonatave të marra nga publiku, krijimi i ambienteve pritëse për publikun dhe caktimi i personelit të dedikuar për marrëdhëniet me publikun, ata (*treguesit*) nuk janë të lidhur me objektiva dhe aktivitete konkrete, por jepen në mënyrë të përgjithshme në pjesën narrative të raportit për vitin e paraardhës.

Së fundi, duhet theksuar edhe fakti që *policia nuk bën raportim të posaçëm publik për zbatimin e planeve të punës me objektiva dhe aktivitete komunitare*. Siç u përmend më lart, strategjitë vjetore të policimit, ku trajtohen edhe çështje të policimit në komunitet, konsiderohen dokumente me përdorim të kufizuar. Ky fakt penalizon transparencën e nevojshme në trajtimin e çështjeve të policimit në komunitet me të gjitha pasojat që ajo ka për besimin e publikut te policia dhe, në fund të fundit, aftësinë e policisë për të kryer detyrën.

## 1.2. Rekomandime për Përmirësimin e Partneritetit me Publikun e Gjerë

- a. Hartimi i një Strategjie Kombëtare Komunikimi me Publikun dhe Median, e cila të përpunojë më tej dhe të kodifikojë të gjitha format tradicionale të komunikimit të njëanshëm midis policisë dhe komunitetit të gjerë;
- b. Ndërtimi i një Plani Veprimi të Integruar (PIV) në rang vendi për policimin në komunitet. Planet e veprimit në nivel qarku të jenë kapituj të planit të integruar;
- c. Krijimi i një strukture përgjegjëse në qendër me këto detyra:
  - udhëheqje metodologjike për drejtoritë e qarqeve në hartimin e planeve të veprimit për policimin në komunitet;
  - monitorim i centralizuar i zbatimit të planeve të veprimit nga struktura përgjegjëse;
  - raportim periodik e publik për zbatimin e planit të integruar të veprimit;
  - koordinimi i veprimeve për zbatimin e dekoncentruar të PIV nga drejtoritë në qarqe;
  - zhvillimi dhe përdorimi i metodave për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve dhe sondimin periodik të perceptimit të publikut për efikasitetin e ndërveprimit të policisë me komunitetin e gjerë.
- d. Caktimi i një pike fokale në çdo komisarjat për çështje të policimit në komunitet;
- e. Hartimi dhe miratimi i një manuali për marketimin në media të policimit në komunitet. Manuali mund të përfshijë formate dhe metoda komunikimi për zhvillimin e fushatave ndërgjegjësimi, të fushatave për sigurinë publike, për sigurinë e trafikut, për informimin e qytetarëve mbi rrugët e ankimit në polici etj;
- f. Program trajnimi për çështje të policimit në komunitet (*metodat e komunikimit me publikun*).

## **2. Bashkëpunimi me Partnerë Privatë të Organizuar (Konsultimi dhe Partneriteti me OJF-të, Biznesin dhe Grupe të tjera të Interesit)**

### **2.1. Gjetje për nivelin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve privatë të organizuar**

Në hyrje të studimit, teksta u përpoqëm t'i bënim një karakterizim të përgjithshëm bashkëpunimit të policisë së shtetit me të ashtuquajturit partnerë privatë të organizuar (*organizata të shoqërisë civile, grupime të biznesit dhe grupe të tjera interesi*), theksuam se marrëdhënia mes tyre shpesh karakterizohet nga një njëanshmëri, por në kah të kundërt, në krahasim me njëanshmërinë që vihet re në ndërveprimin midis policisë dhe komunitetit të gjerë.

Në një përpjekje për të vlerësuar nivelin dhe cilësinë e bashkëpunimit të policisë me këtë segment të komunitetit, ekipi i studimit ka konsultuar një kampion miks prej rreth 100 (*njëqind*) subjektësh nga shoqëria civile dhe biznesi. OJF-të u përzgjedhën mbi bazën e kriterit të profilit të tyre, duke u përqendruar tek ato të cilat specializohen në probleme të tilla si, dhuna në familje, gjakmarrja, trafikimi, të drejtat e grave dhe të të miturve, grupet e margjinalizuara etj. Bizneset u përzgjedhën rastësisht. Metoda e grumbullimit të të dhënave ishte e dyfishtë (*pyetësor elektronik ose biseda gjysmë të strukturuar*). Për më shumë informacion në lidhje me metodën e studimit, ju lutemi t'i referoheni pjesës II të këtij studimi.

Në përfundim të hulumtimit tonë, na rezulton se policia është tipikisht në pozita pritëse e reaguese në ndërveprimin me këtë segment të komunitetit. Janë këto organizata (*sidomos OJF-të e specializuara në fusha të tilla si, dhuna në familje, gjakmarrja, trafiket dhe të drejtat e grave dhe të të miturve*) që i japin tonin kësaj marrëdhënieje dhe priren ta shfrytëzojnë partneritetin me policinë kryesisht për nevojat e tyre.

Ashtu si në rastin e komunitetit të gjerë, edhe partnerët privatë të organizuar tregojnë se janë thellësisht të interesuar për bashkëpunim të efektshëm me policinë. Rezultatet e studimit, gjithashtu, konfirmojnë se të dyja palët janë më se të ndërgjegjshme për përfitimin reciprok të kësaj marrëdhënieje.

Sidoqoftë, gjetjet e studimit për gjendjen reale të komunikimit/ndërveprimit midis këtyre segmenteve të komunitetit dhe policisë përsëri nuk janë shumë optimiste. Kështu, 60% e OJF-ve të intervistuarra pohojnë se policia nuk iu kërkon informacion për problematikën e grupeve në nevojë me të cilat punojnë këto organizata. Po të mbahet parasysh se kampioni i OJF-ve të kontaktuarra, është përzgjedhur mbi bazën e profilit të tyre (*pra, vetëm ato OJF që janë aktive në fushat të tilla si, dhuna në familje, gjakmarrja, trafiket, të drejtat e grave dhe të të miturve, grupet e margjinalizuara etj*), kjo gjetje merr një rëndësi të veçantë. Thënë ndryshe, kjo gjetje sugjeron se policia neglizhon të konsultohet me një numër

të madh organizatash jo qeveritare, të cilat, për nga natyra, e punës së tyre disponojnë informacion dhe *know how* për çështje me rëndësi parësore në punën e policisë.

Ndryshe nga anketimi i OJF-ve të specializuara, anketimi i bizneseve sjell vetëm gjetje të tërthorta për cilësinë e policimit në komunitet dhe të ndërveprimit të policisë me këtë segment të komunitetit<sup>10</sup>. Ndoshta, gjetjet më domethënëse nga ky anketim janë këto:

- Rreth 60% e bizneseve pohojnë se kujdesen vetë (*ose marrin masa shitesë*) për sigurinë e tyre, duke angazhuar polici private apo instaluar sisteme alarmi dhe kamerash (*kjo mund të konsiderohet si një gjetje e tërthortë për cilësinë e policimit*).
- Rreth 70% e bizneseve të kontaktuara pohojnë se nuk janë përfshirë në ndonjë formë ndërveprimit/bashkëpunimi të rregullt me policinë (*kjo është një gjetje e drejtpërdrejtë për nivelin e komunikimit të policisë me këtë segment të komunitetit. Sidoqoftë, vlera e saj është relative, pasi në identifikimin e bizneseve të kontaktuara nuk është përdorur një kampionim shkencor*).

Duhet theksuar se “*vlera provuese*” e gjetjeve të studimit për nivelin e bashkëpunimit të këtij segmenti të komunitetit me policinë është më e fortë, sepse, në këtë rast, (*sidomos në rastin e OJF-ve*) studimi nuk ka vjelur thjesht perceptimin, por përvojat e drejtpërdrejta të këtyre partnerëve të rëndësishëm. Në këtë kuptim rezultatet e këtij ushtrimi, ndonëse jo masive në kuptimin e numrit të subjekteve të konsultuara, janë ndoshta më ilustruese sa i takon nivelin dhe cilësisë së bashkëpunimit midis partnerëve.

Rëndësia e këtyre gjetjeve merr një rëndësi të veçantë, duke mbajtur parasysh se organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset konsiderohen aktorë ligjorë të policimit në komunitet, përderisa përfshirja e tyre në procesin e hartimit të strategjive vjetore të policimit në qark kërkohet nga ligji për policinë (*grupet e interesit*).

Bashkëpunimi me këto segmente të publikut, por edhe me segmente të tjera të organizuara si, p.sh., shoqata, grupime profesionistësh, pakica të organizuara etj do të quhej i arrirë vetëm nëse do t’i ngjante një partneriteti të vërtetë dhe funksional. Maksimalisht, këto segmente të organizuara të komunitetit duhet të përfshihen në programimin e punës së policisë dhe në forma të tjera të policimit në komunitet.

---

10) Theksojmë se rëndësia e gjetjeve nga anketimi i biznesit është relative duke qene se ne kete rast nuk eshte perdorur nje kampionim shkencor i grupit te adresuar.

## 2.2. Rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve privatë të organizuar

- Policia e Shtetit duhet të jetë aktive në kërkimin dhe zbatimin e formave praktike të ndërveprimit me partnerët privatë të organizuar;
- Policia e Shtetit duhet të studiojë të gjitha memorandumet e bashkëpunimit të lidhura me subjekte të këtij segmenti, të analizojë ecurinë në zbatimin e tyre dhe të nxjerrë përfundime për përshtatshmërinë e këtyre instrumenteve (*memorandumeve*);
- Policia e Shtetit duhet të hartojë një model standard të një memorandumi bashkëpunimi me partnerët privatë të organizuar. Memorandumi standard duhet të përdoret nga të gjitha drejtoritë e policisë në qarqe, të cilat duhet të rinegociojnë të gjitha memorandumet ekzistuese mbi bazën e Memorandumit Model dhe të kërkojnë nënshkrimin e memorandumeve të reja aty ku është e nevojshme;
- Memorandumi model duhet të ketë këto karakteristika:
  - *sqarim i përgjegjësive dhe të drejtave përkatëse deri në detaj;*
  - *vendosje e pikave të kontaktit;*
  - *sqarim i procedurave të komunikimit nën përgjegjësinë e titullarit të policisë në qark;*
  - *analizim periodik i zbatimit të memorandumeve;*
  - *raportim periodik për ecurinë e zbatimit;*
- Çdo drejtori e policisë në qark duhet të ndërtojë një *databazë* të plotë me emrat, adresat dhe pikat e kontaktit të organizatave jo qeveritare aktive në fusha të tilla si dhuna në familje, të drejtat e grave, të drejtat e të miturve, trafiqet, gjakmarrja etj. Konsultimi i këtyre subjekteve të bëhet sipas një kalendari të mirëpërcaktuar vjetor dhe në mënyrë publike;
- Çdo drejtori e policisë në qark duhet të zhvillojë këshillime të thjeshta e periodike me përfaqësues të biznesit në qark;
- Policia duhet të raportojë periodikisht dhe publikisht për ecurinë në zbatimin e memorandumeve.

### 3. Bashkëpunimi me Partnerë Shtetërorë - (Konsultimi dhe Partneriteti me Strukturat e Pushtetit Qendror dhe Vendor)

#### 3.1. Gjetje për nivelin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve shtetërorë

Në karakterizimin e përgjithshëm që i bëme partneritetit të policisë së shtetit me partnerët e saj shtetërorë në hyrjen e këtij studimi, theksuam se bashkëpunimi i tyre me policinë funksionon në nivelin e zbatimit në praktikë të detyrave të përbashkëta në fushën e rendit dhe të sigurisë, por është inekzistent në nivel strategjik.

Sa i takon partneritetit, në kuptimin e parë (*praktik*), ai funksion, sepse është një bashkëpunim pragmatik për kryerjen e detyrave përkatëse ligjore. Organe shtetërore të cilat ushtrojnë kompetencat në fusha të tilla si, qeverisja vendore, shëndeti publik, shëndeti mendor, dhuna në familje, shërbimi provës, kujdesi për të miturit etj, janë partnerë natyrorë të Policisë së Shtetit në përpjekjet për të garantuar rendin dhe sigurinë publike.

Partnerët shtetërore të policisë mund të ndahen në 2 (*dy*) kategori:

- Organe të cilave ligjet përkatëse iu njohin përgjegjësi në fushën e rendit publik;
- Organe të cilave ligji iu njeh kompetenca për ekzekutimin e sanksioneve administrative si pasojë e shkeljeve administrative (*përmes shërbimeve përmbartimore*).

Në zbatim të përgjegjësisë së saj për ruajtjen e rendit, policia ka të drejtën ligjore të marrë masa të çastit për të shmangur çdo rrezik që i kanoset rendit dhe qetësisë publike, pavarësisht se trajtimi i situatave që janë bërë burim i rrezikut mund të jetë në kompetencë të organeve të tjera. Më konkretisht, ligji i njeh policisë kompetenca gjenerike dhe paraprahe për të trajtuar përkohësisht rreziqet që rrjedhin nga një mori situatash të tilla si:

- Organizimi i veprimtarive arsimore ose kulturore masive (*p.sh., provimet e maturës ose festat*);
- objekte të rënuara që rrezikojnë jetën e qytetarëve;
- përdorimi i hapësirave publike ose mjediseve private për kryerjen e aktiviteteve, që përbëjnë kundravajtje administrative, me rrezik për shëndetin publik ose që cenojnë qetësinë publike;

- tregtimi ose magazinimi i medikamenteve dhe artikujve ushqimorë jashtë standardit që rrezikojnë shëndetin publik;
- qarkullimi i personave me probleme mendore, të droguar ose të pirë të cilët shqetësojnë qetësinë publike;
- sekuestrimi, konfiskimi ose ndalimi i mjeteve të punës, materialeve të ndërtimit dhe mjeteve të transportit gjatë ose në përfundim të proceseve penale ose administrative;
- largimi i të miturve nga prindi ose kujdestari etj.

Ky fakt e bën shumë të dëshirueshëm bashkëpunimin praktik me policinë për organet e tjera shtetërore, të cilat kanë përgjegjësi parësore për trajtimin e këtyre situatave, sepse, në këtë mënyrë, ato bëjnë të mundur zbatimin e detyrave të tyre ligjore. Thënë ndryshe, ndonëse përgjegjësia kryesore për trajtimin e situatave të lartpërmendura i përket ligjërishit organeve të pushtetit vendor, organeve përgjegjëse për arsimin, shëndetin publik, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e mjedisit, inspektoriateve të ndryshme etj, ligji e autorizon edhe policinë që të veprojë në mënyrë të atypëratyshme për parandalimin e çdo rreziku të mundshëm për rendin dhe sigurinë publike, që mund të vijë nga këto situata. Në këtë kuptim, potenciali për partneritet dhe përfitim reciprok është evident.

Nga ana tjetër, ligji iu vesh organeve të tilla si prefektura, bashkitë dhe komunat përgjegjësi dytësore në fushën e rendit publik (të cilat, natyrisht, mbivendosen me përgjegjësitë primare të policisë në këtë drejtim) si më poshtë:

- përgjegjësi për parandalimin e shkeljeve administrative;
- përgjegjësi për garantimin e zbatimit të akteve të pushtetit vendor;
- përgjegjësi për mbrojtjen civile;
- përgjegjësi për verifikimin, identifikimin dhe regjistrimin e shtetasve; dhe
- përgjegjësi për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike, zbulimin e sipërfaqeve të kultivuara dhe identifikimin e personave përgjegjës.

Edhe në këtë aspekt, potenciali për partneritet është i padiskutueshëm. Në fakt, interesi i lartë i përfaqësuesve të këtyre organeve të shtetit për bashkëpunim efikas me Policinë e Shtetit konfirmohet edhe nga studimi në përfundim të 30 (tridhjetë) biseda gjysmë të strukturuar me përfaqësues të pushtetit vendor, prefekturave, qarqeve dhe drejtorive rajonale në 10 qarqe të vendit.

Sidoqoftë, partnerët shtetërorë, efektivisht, nuk bashkëpunojnë me policinë në nivel strategjik për parandalimin e fenomeneve të tilla shoqërore, të cilat mbarsin rreziqe për rendin dhe sigurinë publike. Ky qëndrim i partnerëve shtetërorë shfaqet shumë qartë në nivelin e ulët të angazhimit në formulimin dhe zbatimin e strategjive vjetore të policimit në nivel qarku.

Gjetjet kryesore mbi nivelin dhe cilësinë e bashkëpunimit të Policisë së Shtetit me këta partnerë shtetërorë janë si më poshtë:

- bashkëpunimi midis policisë dhe partnerëve shtetërorë në nivel zbatues (*për përgjegjësitë e përbashkëta që iu njeh ligji*) funksionon mirë;
- bashkëpunimi midis policisë dhe partnerëve shtetërorë në nivel planifikues dhe strategjik është inekzistent;
- marrëdhënia midis partnerëve në procesin e ndërtimit të strategjive vjetore të policimit në nivel qarku është problematike, për faktin se ajo merret seriozisht vetëm nga policia. Partnerët e tjerë ligjorë nuk ndihen aq sa duhet përgjegjës dhe të përfshirë në këtë proces.

### ***3.2. Rekomandime për përmirësimin e bashkëpunimit mes policisë dhe partnerëve shtetërorë***

Shpjegimet e dhëna më lart ilustrojnë qartë nevojën dhe interesin reciprok për një bashkëpunim funksional midis Policisë së Shtetit dhe partnerëve shtetërorë në policimin në komunitet. Nga ana tjetër, studimi tregon se partneriteti midis tyre është sporadik dhe konsumohet vetëm në formën e ndihmës së ofruar nga policia për kryerjen e detyrave ligjore nga partnerët shtetërorë ose në zbatimin e kompetencave të përbashkëta në fushën e rendit dhe të sigurisë. Studimi arrin në përfundimin se, potenciali i këtij bashkëpunimi është shumë më i madh se kaq. Për të bërë të mundur shfrytëzimin e plotë të këtij potenciali, studimi sugjeron 2 (*dy*) linja veprimi:

- të ngacmohet interesi i partnerëve shtetërorë për forma të reja bashkëpunimi me policinë;
- të formalizohet ligjërisht detyrimi i partnerëve shtetërorë për t'u përfshirë aktivisht në proceset e rëndësishme të planifikimit dhe monitorimit të policimit në komunitet.

*Linja e parë e veprimit* – anketimi dhe hulumtimet cilësore, të kryera në kuadër të studimit, vënë dukje faktin se rendi dhe siguria publike cenohen ose, të paktën, rrezikohen jo vetëm nga veprat penale dhe kundravajtjet administrative (*trajtimi i të cilave është qartësisht në sferën e kompetencave ose të policisë*



ose të partnerëve të tjerë shtetërorë si pushteti vendor dhe inspektoriatet e shumta), por edhe nga një kategori tjetër sjelljesh hibride, të ashtuquajturat *sjellje anti – shoqërore*, të cilat jo vetëm që përbëjnë në vetvete shqetësim real për rendin dhe qetësinë publike, por përmbajnë edhe embrionin e veprave të ardhshme penale ose të kundravajtjeve të ardhshme administrative. Fjala është për sjellje të tilla si:

- Konsumimi i alkoolit në rrugë;
- mungesa e mbikëqyrjes për të miturit;
- mungesa e mbikëqyrjes për kafshët shtëpiake;
- lypja;
- braktisja e automjeteve;
- fërkimi i gomave të automjeteve apo përdorimi eksziv i borive;
- zhurmat që vijnë nga alarmet e ndryshme;
- bërja e zhgarravinave (*graffiti*);
- vendosja e rrezikshme e vazove ose objekteve të tjera nëpër ballkone ose mure;
- hedhja e mbeturinave jashtë vendeve të paracaktuara;
- përdorimi i papërshtatshëm i fishekzjarreve;
- agresioni verbal;
- përdorimi i imitacioneve të armëve;
- zënia e hapësirave të përbashkëta;
- kacafytje dhe vandalizma të tjera;
- përhapja e lajmeve të rreme;
- mospërfillja e urdhrave të ligjshme të autoriteteve shtetërore etj, etj.

Të gjitha këto sjellje kanë potencialin që të evoluojnë në forma të ndryshme të cenimit të rendit (*vepra penale ose kundravajtje administrative*), të cilat bien në sferën e përgjegjësive të policisë ose të partnerëve të tjerë shtetërorë. Për pasojë, trajtimi i tyre parandalues do të ishte me interes për të gjithë partnerët. Sidoqoftë, aktualisht, as policia dhe as partnerët e tjerë shtetërorë, të trajtuar në këtë pjesë të studimit, nuk disponojnë kompetenca adekuate ligjore për trajtimin e tyre.

*Linja e dytë e veprimtimit* - Sa i takon bashkëpunimit të policisë me partnerët shtetërorë në nivel planifikues dhe strategjik, studimi arrin në përfundimin se, niveli i ulët dhe cilësia e dobët e këtij bashkëpunimi përcaktohen nga 2 (*dy*) faktorë:

- mungesa e detyrimit ligjor për partnerët shtetërorë që të angazhohen në procese planifikuese e strategjike për parandalimin e kriminalitetit, përmes aktiviteteve të tilla si, hartimi i strategjive vjetore të policimit në nivel qarku; dhe
- mungesa e koordinimit institucional midis aktorëve shtetërorë në këtë fushë.

Mbi bazën e përfundimeve të mësipërme, studimi sugjeron marrjen e masave të mëposhtme:

- Hartimi i një ligji të posaçëm për sjelljen anti shoqërore, i cili t'u japë policisë, pushtetit vendor dhe inspektoriate të drejtën për të kërkuar nga gjykata lëshimin e urdhrave kufizues për kundravajtësit. Shkelja e këtyre urdhrave kufizues do të konsiderohet kundravajtje penale;
- Ngritja e një komiteti koordinues për policimin në komunitet, sipas modelit të krijuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 07.02.2011 "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij"<sup>11</sup>.

---

11) Ky VKM është miratuar në zbatim të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare". Ligji në fjalë ka për qëllim të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore dhe të garantojë mbrojtje me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje.

Ligji ka katër objektiva kryesorë:

1. krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, lehtësimin e pasojave dhe parandalimin e dhunës në familje;
2. orientimin e punës për krijimin e strukturave dhe organeve përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për mbështetjen e viktimave dhe parandalimin e dhunës në familje;
3. fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj dhunës në familje;
4. sigurimin/garantimin për viktimat e dhunës në familje të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm dhe të thjeshtë në përputhje me ligjin, pranë gjykatës apo organeve të tjera kompetente për zbatimin e ligjit.

Ligji për Dhunën në Familje ka caktuar një mekanizëm që u siguron viktimave të dhunës në familje një urdhër mbrojtjeje, i cili mund të jepet nga një gjykatë civile me kërkesë të viktimës së kësaj dhune. Gjykata duhet ta shqyrtojë kërkesën brenda 15 ditësh. Ka gjithashtu një dispozitë për urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes, të cilët duhet të lëshohen brenda 48 orësh nga gjykata nëse abuzuesi paraqet "kërcënim direkt dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin apo mirëqenien" e viktimës. Gjykata duhet të zhvillojë një seancë tjetër brenda 20 ditëve për të vendosur nëse do ta zgjasë apo ndërpresë urdhrin.

Sipas Ligjit "Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare", lëshimi i një urdhri mbrojtjeje apo një urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes nuk i ndalon palët e interesuara për nisjen e një procesi penal për sa i përket veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë figura të veprave penale.

#### 4. Strukturat

Gjatë vizitave dhe intervistave nëpër qarqe, ne kemi konstatuar mungesën e një pike fokale ekskluzive për çështjet e policimit në komunitet. Në fakt, në vija të përgjithshme, mund të thuhet se adoptimi i metodës së policimit në komunitet nuk ka pse të diktojë nevojën për rishikim të strukturave të policisë, sepse policimi në komunitet thjesht presupozon që funksionet e përhershme policore të kryhen në një mënyrë tjetër. Me fjalë të tjera, po ato struktura të policisë, të cilat janë të ngarkuara me ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në zonat të caktuara (*inspektori i zonës, patrulla e përgjithshme, njësitë përgjegjëse për parandalimin e krimit etj*) duhet të vazhdojnë të bëjnë punën e tyre vetëm se disi ndryshe.

Studimi arrin në përfundimin se nuk ka nevojë për struktura të posaçme të policimit në komunitet në nivel zbatues. Sidoqoftë, thënë kjo, duke parë mungesën e koordinimit dhe të kuptimit midis aktorëve të ndryshëm brenda dhe jashtë policisë, e gjykojmë të nevojshme që të ketë struktura të posaçme për policimin në komunitet në nivel politikëbërës, koordinues dhe monitorues në Drejtorinë e Përgjithshme dhe nga një pikë kontakti në drejtoritë e qarqeve.

Kjo për faktin se, pavarësisht se policimi në komunitet është thjesht një mënyrë policimi, janë gjithsesi të nevojshme disa cilësi specifike, të cilat nuk mund t'i ketë një oficer i pa specializuar. Kjo nevojë del sidomos në kuadrin e veprimtarive të tipit *reach out*, ku funksionarëve të policisë iu takon të bëjnë aktivitete ndërjegjësimi dhe informuese, të cilat presupozojnë cilësi dhe formim të posaçëm.

---

VKM nr. 334 përcakton mekanizmin që duhet të ngrihet në çdo bashki, të përbërë nga tre nivele:

- a. Komitetet drejtuese përbërë nga përfaqësues të institucioneve të ndryshme, si: bashkia, policia, gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria e rrethit, drejtoria arsimore, drejtoria e shëndetit publik, shërbimet sociale pranë bashkisë dhe komunave, zyra e përmbarimit, prefektura, kryetarët e komunave përkatëse, zyra e punësimit, OJF-të, qendrat / strehizat për viktimat e dhunës në familje, institucionet fetare që mund të ofrojnë shërbime për viktimat; dhe kryesuar nga kryetari i bashkisë.
- b. Ekipet teknike ndërdisiplinore përbërë nga përfaqësues teknikë të institucioneve të përfaqësuara në komitetin drejtues, përfaqësues të njërive për mbrojtjen e fëmijëve dhe nëpunësve vendorë të barazisë gjinore, si dhe nga profesionistë të lirë: avokatë, psikologë etj.
- c. Koordinatorët vendorë për referimin e rasteve të dhunës në familje, të cilët janë përfaqësues të zyrës së shërbimeve sociale pranë njësisë vendore, njëherëshi drejtues të punës së ekipit teknik ndërdisiplinor.

#### IV. REFERENCAT

1. *Strategjia Sektoriale e Rendit Publik 2007 – 2013;*
2. *Strategjia 7-vjeçare të Policisë së Shtetit lidhur me Policimin në Komunitet;*
3. *Plani i Veprimit Operacional 2008 – 2010 Për Implementimin e Policimit në Komunitet;*
4. *Community Policing – Theory & Practice - Aspen Institute;*
5. *Community Policing: A critical Analysis of a Small Police Department – Gregory E. Summer;*
6. *Anti – Social Behavior Act 2003;*
7. *Raport Studimor: Kapacitetet dhe efektiviteti i programit të policimit në komunitet;*
8. *Manuali i Procedurave Standarde për Rendin dhe Sigurinë Publike;*
9. *The Critical Link: Community Policing Practices in Southeastern Europe - UNDP Albanian SSSR Programme;*
10. *Policy Brief 1: Towards a New Approach for Crime Prevention – Institute for Democracy and Mediation 2008;*
11. *Besimi Publik – Sfidë për Policinë - Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) 2007;*
12. *Foretold Insecurity – Crime Trends in Albania 2008 – 2011 – IDM;*
13. *Tendencat e Krimit në Shqipëri 2012 IDM;*
14. *Protokoll i mbledhjes së Grupit të Politikave (01.02.2012) për shqyrtimin e projekt- strategjive vjetore të policimit në komunitet të 12 Drejtorive të Policisë në Qarqe;*
15. *International Consortium Meeting Highlights IC Community Policing/Crime Prevention, 12 April 2013;*
16. *Praktika të Mira për Ndërtimin e Partneritetit Polici – Publik OSBE 2008;*
17. *Reforms of the Albanian Police 1991 – 2000;*
18. *White Paper of the UK Home Office – Respect and Responsibility – Taking a Stand against Anti – Social Behavior 2003;*
19. *Case Studies*
- 19.1 *Policia në Bashkësi/Policia e Kosovës 1999 – 2012 – Prezantim dhjetor 2012;*
- 19.2 *Republika e Kroacisë, Ministria e Brendshme, Administrata Policore e Zagrebit (Shërbimi për Parandalimin) – Policimi në Komunitet - Prezantim dhjetor 2012;*
- 19.3 *Community Policing Action Plan Croatia;*

- 19.4 *Policimi në Komunitet në Slloveni - Prezantim dhjetor 2012;*
- 19.5 *Policimi në Komunitet në Suedi - Prezantim dhjetor 2012;*
20. *Ligj Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore";*
21. *Ligji Nr. 9296, datë 21.10.2004 "Për Verifikimin, Identifikimin dhe Regjistrimin e Shtetasve nga Njësitë e Qeverisjes Vendore";*
22. *Ligj Nr. 9559, datë 08.06.2006 "Për një Shtesë në Ligjin Nr. 7975, datë 26.07.1995 "Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope";*
23. *Ligj Nr. 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile";*
24. *Ligj Nr. 8927, datë 25.07.2002 "Për Prefektin";*
25. *Ligj Nr. 9669, datë 18.12.2006 "Për Masat ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare";*
26. *VKM Nr. 334, datë 17.02.2011 "Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare dhe Mënyrën e Procedimit të tij";*
27. *Ligj Nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë e Shtetit";*
28. *Ligji Nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë";*
29. *Ligj Nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative"*
30. *Ligji Nr. 03/L-142 i Republikës së Kosovës "Për Rendin dhe Qetësinë Publike";*
31. *Programi i Qeverisë për Rendin Publik 2013;*
32. *Strategjitë vjetore të sigurisë dhe policimit në komunitet në qarqet Tiranë, Durrës, Lezhë, Shkodër, Dibër, Kukës, Berat, Elbasan, Vlorë, Korçë, Gjirokastrë dhe Fier.*

## V. ANEKSET

### 1. Shënime mbi metodologjinë

#### *Objektivi i Studimit*

Me synimin e saktësisimit të fushës së veprimit të këtij studimi, u krye një rishikim i literaturës përkatese, për të krijuar një pamje të plotë të gjendjes aktuale të policimit në komunitet. Ky shqyrtim konsistoi në rishikimin analitik të të gjitha dokumenteve më të fundit dhe të disponueshme mbi partneritetin, në kuadrin e policimit në komunitet në Shqipëri, përfshirë këtu raporte dhe publikime të aktorëve të tjerë (*publikë, privatë dhe organizata ndërkombëtare*) që zhvillojnë aktivitetin e tyre në këtë fushë. Politikat Kombëtare, Strategjitë Kombëtare dhe materiale të tjera relevante përbëjnë bazën mbi të cilën u krye kjo analizë (*shih më poshtë listën e plotë të referencave*).

Në përputhje me Termat e Referencës, projekti pati një mbulim kombëtar. Për këtë arsye, gjatë fazës fillestare të projektit u krye identifikimi dhe lokalizimi i të gjithë aktorëve në nivel kombëtar dhe rajonal. Në vijim, u përpilua lista e treguesve kyç që do të shërbenin në vlerësimin e mekanizmit ekzistues të partneritetit, që, më vonë, u përfshi në dhe në pyetësorin për punën në terren.

Ekipi i projektit zhvilloi intervista me aktorët kryesorë në të gjitha 12 qarqet. Grupet e interesit përfshinin të rinjtë, drejtoritë rajonale të policisë, organizata të shoqërisë civile, organizata biznesi, njësitë e pushtetit vendor në nivel qarku dhe bashkie, duke përfshirë dhe zyrat e prefektëve. Gjithashtu, u kryen takime me përfaqësues të lartë të Ministrisë së Brendshme, me Policinë e Shtetit, si dhe me organizata të huaja e projekte që trajtojnë direkt ose indirekt policimin në komunitet. Vëmendje e veçantë iu kushtua grupeve në nevojë e, si rrjedhojë, organizatat aktive në punën me këto grupe dhe në çështjet e drejtave të njeriut u përfshinë në listën e takimeve me përparësi.

#### *Strategjia e përzgjedhjes së kampionit dhe sondazhi i qytetarëve*

Një pjesë e rëndësishme e punës në terren ishte dhe kryerja e një sondazhi, që kishte si objektiv kryesor mbledhjen dhe analizën e perceptimit të qytetarëve mbi angazhimin e tyre në modelin e

praktikat ekzistuese të partneritetit me policinë e shtetit. Përveç vjeljes së perceptimit, studimi u përpoq, në të njëjtën kohë, të zbulonte se cilët mund të ishin disa nga faktorët që ndikojnë në gati-shmërinë e tyre për të marrë pjesë në këtë partneritet, si dhe cila do ishte ajo formë partneriteti apo model që do ta mbështeste më mirë zbatueshmërinë e ligjit, parandalimin dhe luftën kundër aktiviteteve të lehta dhe të rënda kriminale në komunitet.

Këto aspekte ishin pjesë e këtij hulumtimi që u krye nëpërmjet 700 intervistave individuale, me pyetje të mbyllura, sipas specifikave të kampionit që përshkruhen më poshtë.

**Sondazhi u krye në Qarkun e Tiranës**, në të cilin jetojnë rreth çereku i popullsisë së vendit. Tirana, u përzgjedh, gjithashtu, si rrjedhojë e ndërthurjes së shumë faktorëve, përfshirë kombinimin e komuniteteve të ndryshme, si dhe zonat e reja urbane me një shifër të lartë papunësie, ku të ardhurit rishtas bashkëjetojnë me komunitete tradicionalisht të forta nga zonat rurale dhe urbane. Rrjedhimisht, ky kompleksitet i paraqitur në kampionin e sondazhit u konsiderua si përfaqësues në lidhje me policimin në komunitet.

Duke pasur parasysh rëndësinë që iu ishte kushtuar përfaqësimit të të rinjve në Termat e Referencës së projektit, iu kushtua këtij grupi një vëmendje më e madhe gjatë përgatitjes së kampionit (*grup mosha 15 – 35*). Pjesa tjetër e kampionit u grupua në bazë të të dhënave demografike të shpërndarjes së popullsisë.

Rreth 100 biznese dhe OJF u përzgjedhën për një intervistë pjesërisht të strukturuar. OJF-të u përzgjedhën për nga fokusi i punës së tyre (*jo vendndodhja gjeografike*) në fushë e shërbimeve sociale e aktiviteteve në mbështetje të komunitetit në përgjithësi e grupeve vulnerabël në veçanti.

## 2. Gjetjet kryesore nga puna në terren

### 2.1. Rendi publik dhe ndërveprimi me policinë e shtetit në nivel qarku – përmbledhje e përgjithshme

Sondazhi paraqet gjetje interesante në lidhje me perceptimin e publikut mbi punën e policisë dhe ndërveprimin midis tyre. Nga numri total i të intervistuarve vetëm OJF-të duket se kanë kërkuar mbështetjen e policisë gjatë aktiviteteve të tyre (60% e OJF-ve të intervistuar), ndërsa ky nuk është rasti me komunitetin e biznesit (vetëm 5% mendojnë se do të përfitonin më shumë nga mbështetja e policisë) dhe me pjesën tjetër të grupeve të përzgjedhura në kampion (vetëm 22% e të gjithë të anketuarve).

Kur u pyetën rreth një liste të çështjeve dhe problemeve të mundshme, vjedhja u rendit e para,

ndjekur nga ndotja akustike dhe ndotja e mjedisit në përgjithësi (68%), kultivimi, shitja dhe konsumi i lëndëve narkotike (56%) dhe alkooli (47%), si dhe dëmet fizike (43%), të evidentuara pranë vendit ku të anketuarit zhvillojnë aktivitetin e tyre. Qytetarët u shprehën se kanë informacion ku mund t'i adresojnë shqetësimet e tyre në lidhje me çështjet e sipërpërmendura.

Pothuaj të gjithë të anketuarit e konsiderojnë të sigurt zonën ku jetojnë dhe zhvillojnë aktivitetin e tyre. Në përgjithësi, ka një ndjesi sigurie mes anëtarëve të komunitetit në Tiranë me një përqindje përgjigjesh 38% (gjithmonë) dhe 41% (në përgjithësi). Kjo ishte e vlefshme edhe në rastet e qëndrimit deri në orët e vona të natës, e cila gjithashtu mund të jetë rezultat i patrullimit të policisë në qytet.

Tabela 1. Perceptimi i qytetarëve mbi sigurinë

	Grup moshë 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Pa përgjigje	2	0,66%	1	0,26%	3	0,44%
Gjithmonë	109	36,09%	158	41,25%	267	38,98%
Në përgjithësi	139	46,03%	147	38,38%	286	41,75%
Të pavendosur	31	10,26%	45	11,75%	76	11,09%
Kurrë	21	6,95%	32	8,36%	53	7,74%

Shumica e të anketuarve theksuan se nuk kishin kontaktuar policinë për asistencë (rreth 75%), edhe pse kishin njohuri se ku duhet të drejtoheshin në rast të një ngjarjeje të pakëndshme. Vetëm rreth 20% e të dy grupmoshave (të rinjtë dhe pjesa tjetër e të intervistuarve) kanë kontaktuar me policinë dhe arsyeja ka qenë kryesisht sepse kanë qenë dëshmitarë të rastësishëm në ngjarje. Një përqindje e lartë e të anketuarve (75%) nuk kanë dhënë përgjigje kur janë pyetur nëse kanë raportuar ndonjë ngjarje në polici, ndërkohë që vetëm 17% e të intervistuarve kishin bërë një raportim.



Tabela 2. Shkalla e raportimit të rasteve në departamentin e policisë

Përgjigje	Grup mosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Jo	%	Jo	Përgjigje	Jo	%
Pa përgjigje	197	65,23%	307	80,16%	504	73,58%
Po	57	18,87%	64	16,71%	121	17,66%
Jo	48	15,89%	12	3,13%	60	8,76%

**Mungesa e besimit tek policia** u deklarua nga një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (rreth 11.6%), si arsyeja për mos-raportimin e një ngjarjeje. Interesant ishte fakti se, në këtë shifër, grupmoshat e reja shfaqin përqindjen më të lartë me 14.5%, në krahasim me grupmoshat e tjera të intervistuar me 9.4 %. Me tej, 23% e të rinjve raportuan se arsyeja e mos raportimit ishte se do ta zgjidhnin vetë problemin.

Tabela 3. Arsye për mos-raportim të një ngjarjeje në polici

Përgjigje	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	Përgjigje	Nr.	%
Pa përgjigje	135	44,70%	265	69,19%	400	58,39%
Nuk i besojmë policisë	44	14,57%	36	9,40%	80	11,68%
Do të zgjidhim vetë problemin	70	23,18%	30	7,83%	100	14,60%
Të tjera	51	16,89%	54	14,10%	105	15,33%
Të dyja	2	0,66%	0	0,00%	2	0,29%

Shumica e të anketuarve (58%) theksuan se nuk e favorizojnë regjistrimin e tyre ose të një anëtarit të familjes në strukturat e policisë së shtetit. Sërish, të rinjtë, të cilët janë grup shumë i rëndësishëm për partneritetin e policimit në komunitet, duket se janë veçanërisht të pa interesuar të hyjnë në forcën e policisë (65% e të anketuarve), duke dëshmuar kështu mbi **problematikën e imazhit publik të policisë**.

Tabela 4. *Interesi për të hyrë në forcat e policisë*

	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	Përgjigje	Nr.	%
Po përgjigje	2	0,66%	3	0,78%	5	0,73%
Po	103	34,11%	180	47,00%	283	41,31%
Jo	197	65,23%	200	52,22%	397	57,96%

## 2.2. *Kuadri i punës dhe strategjia e policimit në komunitet*

Intervistat vunë në dukje se shumica e departamenteve të policisë nuk kanë një strategji të dedikuar të policimit në komunitet. Kjo pjesë është e integruar me strategjinë vjetore të policisë në çdo qark, duke ndjekur udhëzimet nga Drejtoria e Përgjithshme.

Në qarkun e Kukësit, policimi në komunitet ishte objektivi XI i strategjisë kryesore mbi “Ndërtimin e partneritetit dhe bashkëpunimin me institucione dhe faktorë të tjerë me influencë në qarkun e Kukësit”. Ky objektivi ishte shtjelluar në një plan me 5 masa. Ato përfshinin një grup masash të përbashkëta në bashkëpunim me njësinë e qeverisjes vendore dhe komunitetin, si dhe masa bashkëpunimi me biznesin. Strategjia parashikon takime/konsultime çdo tre muaj. Megjithatë, duket se këto takime nuk organizohen sipas një kalendari zyrtar, por zhvillohen në mënyrë sporadike për çështje specifike ose si takime midis stafit përgjegjës për marrëdhëniet me institucionet. E njëjta përgjigje u vërtetua edhe për bashkëpunimin me biznesin. Takimet ishin të orientuara ndaj problemeve me të cilat ballafaqohesh një ose më shumë biznese dhe nuk kishin të bënin me policimin në komunitet.

Në qarkun e Durrësit ekziston një strategji për policimin në komunitet e shoqëruar me strategjitë vjetore, si dhe një grup pune me strukturat e policisë së qarkut për përgatitjen e saj. Këto strategji vjetore janë të ndërthurura me strategjinë kryesore të policisë së shtetit. Në qarkun e Fierit ka, gjithashtu, një strategji policimi. Gjatë 2007-2008 janë zhvilluar trajnime mbi policimin në komunitet në Maqedoni. Trajnime janë zhvilluar me shkollat fillore dhe me Drejtorinë Rajonale të Arsimit. Gjithashtu, dy specialistë janë përgjegjës për dhunën në familje.

Në qarkun e Vlorës ka një strategji dhe një plan veprimi të dedikuar për sezonin turistik. Fletëpalosje në shqip dhe në gjuhë të huaja janë përgatitur mbi mënyrën sesi mund të kontaktohet me policinë. Në qarkun e Elbasanit ka një strategji të veçantë për policimin në komunitet, e formuluar në konsultime me

strukturat përkatëse. Më parë, policimi në komunitet ishte një strukturë e veçantë, po aktualisht është pjesë e strukturës së hetimit dhe parandalimit të krimit. Puna e inspektorit në lagje është thelbësore për policimin në komunitet, pasi ai është personi përgjegjës për çfarë ndodh në zonën që ai mbulon dhe ka informacionet e duhura mbi problemet e saj. Integriteti i këtij personi është parësor, pasi ai duhet të udhëheqë në komunitet me shembull personal, në mënyrë që të fitojë besimin e qytetarit.

Në departamentin e policisë janë tre njësi që ndjekin çështjet e dhunës gjinore. Njësia duket se punon mjaft mirë në mbrojtjen e grave të dhunuara. Departamenti i policisë zhvillon një program trajnimi për punonjësit e tij, si dhe jep trajnime periodike për të rinjtë në shkollat e mesme sipas kërkesës së departamentit të arsimit. Problemet lidhen me numrin e pakët të burimeve njerëzore, që ndikon në mbulimin e të gjithë qytetit, si dhe mungesën e automjeteve. Angazhimi i personelit ekzistues të policisë me detyra shtesë shkakton pamjaftueshmërinë e numrit të personelit. Në Elbasan problemet më të shpeshta janë vjedhjet dhe dëmtimet e pronës private. Nuk janë raportuar çështje me komunitetet etnike.

Departamenti i policisë në qarkun e Shkodrës i referohet një dokumenti me 50 faqe, me titull “Strategjia Vjetore e Policimit në Komunitet 2013”, e miratuar në 17 prill 2013. Megjithatë, u vu re se strategjia nuk ishte publikuar siç duhet dhe kishte mungesë të praktikave unifikuese që strategjia të ishte e disponueshme për publikun. Në të vërtetë, shefi i njësisë përkatëse pranoi se dokumenti i strategjisë nuk ishte i hapur për publikun e gjerë, ai i ishte dërguar vetëm Qarkut dhe Prefekturës. Nuk kishte një plan komunikimi për strategjinë – thjesht konsultime të shpeshta me publikun mbi parandalimin e ngjarjeve. Praktika është që drejtori, çdo tre muaj, analizon progresin e zbatimit të strategjisë.

Kryesisht, Shërbimet Sociale, nëpër Bashki dhe Departamentet Arsimore, e njohin rëndësinë e policimit në komunitet, por pranojnë se nuk janë konsultuar, madje nuk e kanë parë strategjinë e policimit. Në rastin e Shkodrës, Bashkia ishte ftuar të merrte pjesë në një eveniment të policimit në komunitet, në lidhje me mbrojtjen e studentëve ndaj përdorimit të alkoolit dhe drogave, ndërsa trajnimet, në përgjithësi, u raportuan si sporadike. Njësitë vendore pohuan se çështje të veçanta si, mbrojtja e femrave ndaj dhunës në familje dhe mbrojtja e fëmijëve, mund të trajtohen më mirë nëpërmjet partneriteteve funksionale në kuadër të policimit në komunitet.

U vu re që, në përgjithësi, nuk ka struktura të dedikuara për policimin në komunitet dhe kjo detyrë duket të jetë e shpërndarë. Për sa i përket marrëdhënieve me institucionet, çdo anëtar i personelit kishte për detyrë mbarëvajtjen e marrëdhënieve me organe të caktuara vendore. Nga ana tjetër, për dhunën në familje duket se ka përpjekje për ta trajtuar në mënyrën e duhur nga strukturat e policisë e në disa prej drejtorive rajonale, sikurse ishte edhe rasti i Beratit, ka një person për mbulimin e këtyre çështjeve.

### 2.3. Bashkëpunimi dhe angazhimi me policinë e shtetit në qarqe

Nga këndvështrimi i policisë, bashkëpunimi me zyrën e Prefektit dhe departamentet rajonale, veçanërisht atë të arsimit, duket të jenë prezent. Në fakt, çështjet në shkolla konsiderohen si të zbuluara, ndërkohë që **policia nuk është më prezente** në çdo shkollë, **pasi departamentet e arsimit nuk kanë fonde për t'i paguar**. Besohet se, prezenca e policisë do të ndihmojë më shumë në parandalimin e rasteve të dhunës, përdorimit dhe shpërndarjes së lëndëve narkotike, si dhe çështjeve të tjera sociale. Sikurse e artikuloi edhe drejtori i policisë rajonale në Berat, “pas çdo të riu të dhunshëm mund të fshihet një realitet i vështirë familjar, i cili, nëse evidentohet në kohë, mund të parandalojë probleme që lidhen drejtpërdrejtë me vetë të riun apo probleme që mund t'i shkaktohen familjes nga përdorimi i alkoolit dhe drogave”.

Sondazhi tregon se **bashkëpunimi me policinë është i një rëndësie të lartë për OJF-të (70%) dhe për shumicën e të anketuarve (84%)**. Megjithatë, vetëm rreth 20% e të gjithë të anketuarve pohojnë se kanë bërë një kallëzim në polici dhe se përgjigjja e policisë ka qenë e pranueshme.

Interesante ishte gjetja se, shumica e të anketuarve nga OJF-të (73%) dhe nga biznesi (66%) nuk kishin dijeni mbi ekzistencën e ndonjë mekanizmi formal të bashkëpunimit/partneritetit midis policisë dhe aktorëve kryesorë të komunitetit. Në fakt, shumica e OJF-ve dukej se nuk kishte informacion mbi ekzistencën e Strategjisë së Policimit në Komunitet në qarkun e tyre dhe se nuk kishin marrë ndonjë ftesë për konsultime gjatë procesit të hartimit të saj.

Në vijim, **përprjekjet e policisë për të mbledhur informacion nga anëtarët e komunitetit dhe OJF-të lokale u vlerësuan si të dobëta**. Rreth 60% e të anketuarve pohuan se nuk kishin marrë ndonjë kërkesë ose ftesë nga departamentet e policisë për të shkëmbyer informacion mbi rendin publik dhe sigurinë, të lidhura me komunitetin e gjerë dhe grupet e cenueshme (*vulnerable*) me të cilat punojnë rregullisht këto OJF.

Rreth 55% e të anketuarve nga komuniteti i biznesit pranuan se do të **merrnin pjesë me dëshirë në takime ose konsultime periodike me policinë** për të diskutuar mbi çështje dhe shqetësime mbi rendin publik. Ndërkohë që vetëm 30% e OJF-ve të intervistuarra kanë komunikime të përhershme me departamentin e policisë që mbulon fushën e veprimtarisë së tyre.

Pavarësisht se ka një lloj ngurrimi në lidhje me besimin ndaj policisë së shtetit, pjesa më e madhe e të anketuarve, nga sondazhi i qytetarëve (51%), u shprehën pozitivë për të bashkëpunuar me policinë në të ardhmen në iniciativa partneriteti.

Tabela 5. *Gatishmëria për të bashkëpunuar me policinë*

Përgjigje	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	Përgjigje	Nr.	%
Pa përgjigje	1	0,33%	1	0,26%	2	0,29%
Po	148	49,01%	202	52,74%	350	51,09%
Jo	83	27,48%	110	28,72%	193	28,18%
Nuk e di	70	23,18%	70	18,28%	140	20,44%

Të anketuarit duket se i njohin me emër dhe fytyrë punonjësit e policisë në komunitetin e tyre. Ndërkohë, kur shohin një punonjës policie. që patrullon në lagjen e tyre. paraqiten të ndarë në “të qetë” (39%) ose thjesht indiferentë (30%). Shumica e të anketuarve e di vendndodhjen (76%) dhe numrin e telefonit (rreth 72%) e departamentit të policisë nëse duan të kontaktojnë. Megjithatë, rastet e takimeve me policinë vendore, për arsye informimi, janë të pakta (30%).

Tabela 6. *Rastet e takimeve me policinë lokale për arsye informimi*

Përgjigje	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	Përgjigje	Nr.	%
Pa përgjigje	1	0,33%	2	0,52%	3	0,44%
Po	86	28,48%	122	31,85%	208	30,36%
Jo	215	71,19%	259	67,62%	474	69,20%

Përpjekjet e Policisë në zgjidhjen e problemeve të komunitetit vlerësohen si ‘deri diku të mjaftueshme’ prej 49% e qytetarëve të intervistuar. Ndërsa, angazhimi i policisë për bashkëpunim me komunitetin është renditur “disi e kënaqshme” nga 59% e të anketuarve. Interesante është se ky cilësim rezulton të jetë është më i lartë për të rinjtë e anketuar (10% më i lartë se mendimi i të anketuarve të grup moshës 35-69).

Tabela 7. Përpjekjet e Policisë për ruajtjen e rendit publik dhe sigurisë në komunitet

	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Pa përgjigje	2	0,66%	5	1,31%	7	1,02%
Maksimalisht	12	3,97%	28	7,31%	40	5,84%
Shumë	55	18,21%	67	17,49%	122	17,81%
Disi	149	49,34%	160	41,78%	309	45,11%
Pak	57	18,87%	89	23,24%	146	21,31%
Aspak	27	8,94%	34	8,88%	61	8,91%

**Niveli i respektit ndaj policisë së shtetit u konsiderua kryesisht si mesatar nga të anketuarit (40%).** Rreth 22% theksuan se kishin një respekt të lartë ndaj policisë së shtetit, ndërsa 25% e totalit të përgjigjeve i përkisnin kategorisë së nivelit të ulët të respektit ndaj policisë. Interesante është se, frekuenca e përgjigjeve pozitive (nivel i lartë dhe i mesëm respekti) nga të rinjtë është pak më e lartë nga grupmoshat e tjera.

Tabela 8. Niveli i respektit ndaj policisë së shtetit

	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Pa përgjigje	2	0,66%	4	1,04%	6	0,88%
Shumë e lartë	27	8,94%	53	13,84%	80	11,68%
E lartë	76	25,17%	75	19,58%	151	22,04%
Mesatare	129	42,72%	145	37,86%	274	40,00%
E ulët	68	22,52%	106	27,68%	174	25,40%

**Marrja e mendimit qytetar mbi shërbimet e policisë duket të jetë një çështje tjetër që kërkon vëmendjen e strukturave të policisë së shtetit.** Rreth 85% e të anketuarve theksuan se nuk u ishte kërkuar mendim lidhur me performancën e policisë së shtetit, si dhe për çështje të tjera të komunitetit.

Tabela 9. Mekanizmi i mbledhjes së mendimeve të komunitetit

	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Pa përgjigje	8	2,65%	6	1,57%	14	2,04%
Po	56	18,54%	26	6,79%	82	11,97%
Jo	238	78,81%	351	91,64%	589	85,99%

Rreth 13 % e të anketuarve besojnë se mendimi qytetar mund të influencojë disi punën e policisë së shtetit. Nga ana tjetër, ka një shkallë të lartë pa-përgjigje (68%), e cila mund të tregojë se qytetarët mund të kenë dyshime rreth procesit gjithëpërfshirës dhe marrjes në konsideratë të mendimit të tyre. Kjo dukuri është më e lartë në grup moshat 35-69, me 82% krahasuar me 50% të mos përgjigjeve të të anketuarve pjesëmarrës në sondazh. Kjo rithekson argumentin se te rinjtë janë disi më skeptikë lidhur me impaktin e mendimit të qytetarëve mbi punën e policisë së shtetit me 21%, krahasuar me 7.5% të pjesës tjetër së të intervistuarve.

Tabela 10. Opinioni mbi impaktin e mundshëm të mendimit të qytetarëve mbi punën e policisë së shtetit

	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Pa përgjigje	154	50,99%	316	82,51%	470	68,61%
Shumë	21	6,95%	20	5,22%	41	5,99%
Disi	64	21,19%	29	7,57%	93	13,58%
Pak	45	14,90%	12	3,13%	57	8,32%
Aspak	18	5,96%	6	1,57%	24	3,50%

Mbi të gjitha, njohuritë e kufizuara (66% e të anketuarve) mbi ekzistencën e çdo lloj mekanizmi partneriteti në komunitet vë në dukje sërish nevojën për një partneritet policimi më të fortë dhe funksional në komunitet, i cili të jetë gjithashtu i dukshëm dhe i aksesueshëm nga të gjitha grupet që do të dëshirojnë të përfshihen në të.

Tabela 11. Informacion mbi grupime apo organizata për rendin publik dhe sigurinë në komunitet

Përgjigje	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Pa përgjigje	6	1,99%	12	3,13%	18	2,63%
Po	71	23,51%	46	12,01%	117	17,08%
Jo	177	58,61%	278	72,58%	455	66,42%
Nuk e di	48	15,89%	47	12,27%	95	13,87%

Bashkëpunimi me policinë është renditur si shumë i rëndësishëm nga 84% e të anketuarve, ndërsa rreth 50% e tyre shprehën vullnetin për pjesëmarrje të mundshme në grupet e policimit në komunitet. Në vazhdim, sikurse u komentua edhe nga disa të anketuar, **paraqitja në media dhe informacioni i disponueshëm** për publikun, përfshirë edhe shembuj të praktikave me të mira të partneritetit të policimit në komunitet mund të sigurojë një mbështetje me të mirë të këtij procesi. Kjo, gjithashtu, do të hapë rrugën për ndërtimin e besimit të komunitetit ndaj shfrytëzimit dhe efektshmerisë të këtyre partneriteve.

Në disa qarqe janë krijuar ekipe të përbashkëta me seksionin e arsimit për trajnime në shkolla mbi temat e dhunës, alkoolit dhe lëndëve narkotike. Manualët e trajnimit janë përgatitur dhe trajnimet zhvillohen nga dy oficerë policie dhe një punonjës i seksionit të arsimit.

Angazhim më i madh pritët nga strukturat vendore dhe seksioni i shëndetësisë. Një shembull konkret jepet në Berat – trajtimi i personave me aftësi të kufizuar mendore. Në rastet kur kërkohet ndihma e komunitetit për raste të tilla, ekipi mjekësor vjen me prezencën e policisë dhe, shpesh, policia mbetet me detyrën e transportit në spitalin rajonal ose në një spital tjetër. Ekipi mjekësor nuk ka bashkëpunuar dhe i ka lënë barrën policisë – burime të pakta njerëzore, si dhe mungesë e trajnimit të përshtatshëm.



Tabela 12. Perceptimi qytetar mbi bashkëpunimin e policisë së shtetit me komunitetin

Përgjigje	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Pa përgjigje	4	1,32%	5	1,31%	9	1,31%
Shumë i rëndësishëm	249	82,45%	329	85,90%	578	84,38%
Disi i rëndësishëm	40	13,25%	46	12,01%	86	12,55%
Jo i rëndësishëm	9	2,98%	3	0,78%	12	1,75%

Këndvështrimi i drejtorëve të policisë është se **policia është shumë e kualifikuar**, pasi ka marrë pjesë në trajnime të shumta të organizuara nga aktorë të ndryshëm – përfshirë shoqërinë civile. Në rastin e komunitetit Rom, gjithashtu, u përmend bashkëpunimi me krerët e këtij komuniteti dhe organizatat që operojnë në këtë fushë.

Bashkëpunimi me individë është shpesh i kufizuar në raste të veçanta individuale, të cilat policia i konsideron konfidenciale ose të klasifikuara. Ky bashkëpunim raportohet se është shumë eficient. Dhuna në familje paraqitet si një nga çështjet me shqetësuese në Kukës dhe Berat. Kultivimi i narkotikëve, gjithashtu, u vu në dukje, së bashku me nevojën për një bashkëpunim më të mirë me njësitë e qeverisjes vendore. Një rast i pazakontë vetë-helmimi u identifikua në Berat. Ndërkohë që në Durrës u përmendën bashkëpunimi me grupe të ndryshme, veçanërisht të rinjtë, si dhe zhvilluar trajnimet mbi sigurinë në rrugë dhe transport, edukimin ligjor dhe rritjen e ndërgjegjësimit mbi drogat. Një marrëveshje bashkëpunimi një vjeçare është firmosur me drejtorinë arsimore, si dhe janë zhvilluar trajnime dhe me komunitetin Rom. Gjithashtu, vlen të përmenden se trajnimet apo aktivitetet që i përkasin policimit në komunitet shpesh kanë qenë të mbështetura nga projekte të ndryshme të partnerëve vendor. Në rastin e Durrësit, trajnimet u promovuan nga një OJF Rome gjatë zbatimit të një projekti, në të cilin ata mbështesnin partneritetin e policisë në aktivitetet e rritjes së ndërgjegjësimit. U përmendën dhe raste të tjera të bashkëpunimit me OJF jo-Rome në kuadër të projekteve që ato zbatojnë.

Në Vlorë zhvillohen takime të planifikuara të personave të zgjedhur lokalisht me komunitetin, por ato janë të përqendruara tek narkotikët, si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta të organizuara nga autoritetet vendore. Konfliktet mbi pronën ishin çështje prezente në Vlorë, si dhe rezultonte që policia kish çuar në gjykatë mjaft raste kundër subjekteve që hedhin mbetje në det e u ishte dashur të gjenin arsyen e përshtatshme për t'i prezantuar gjykatës çështjet në fjalë (të tilla si “ndërtime të paligjshme”).

Në Elbasan është vendosur bashkëpunimi me këshillin e qarkut, këshillin bashkiak, policinë bashkiake, seksionin e arsimit dhe komunitetin Rom. Ky komunitet është i madh në qarkun e Elbasanit dhe takime të shpeshta zhvillohen me ta për t'u informuar mbi problemet e tyre.

Departamentet e Policisë e konsiderojnë bashkëpunimin me qytetarët, në lidhje me ligjin dhe rendin, si të mirë në përgjithësi, por jo 100%. Në rastin e Shkodrës, partneritete për policimin në komunitet janë vendosur me prefekturën, departamentet e shërbimit publik, bashkitë dhe komunat, si dhe seksionet e arsimit dhe shkollat. Shkollat dhe grupet e cënueshme si Romët dhe Egjiptianët, janë ndër partnerët me aktivë. Për arsye se strategjia vjetore e policimit në komunitet përqendrohet tek grupet e cënueshme, pritet që të këtë një përfshirje më të gjerë të shoqërisë civile.

Tabela 13. *Gatishmëria për pjesëmarrje në grupime apo organizatat të krijuara për policimin në komunitet*

	Grupmosha 15-34		Grupmosha 35-69		TOTALI	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
Pa përgjigje	4	1,32%	5	1,31%	9	1,31%
Po	149	49,34%	195	50,91%	344	50,22%
Jo	72	23,84%	125	32,64%	197	28,76%
Nuk e di	77	25,50%	58	15,14%	135	19,71%

Procedurat për raportimin e ngjarjeve nga komuniteti janë të thjeshta. Shërbimet e policisë të zgjeruara në terren, si dhe patrullat e përgjithshme po ndihmojnë raportimin nga komuniteti. Në vijimësi, inspektorët e rendit, që mbulojnë krimet e lehta, janë në kontakt të vazhdueshëm me komunitetin dhe policia ka vënë në dispozicion numrat e kontaktit 125 dhe 126, nëpërmjet shpërndarjes së fletë palosjeve. Megjithatë, mendohet se nuk është e mjaftueshme vetëm njohja e inspektorëve lokalë nga komuniteti.

Inspektorët e lagjeve/zonave luajnë një rol vendimtar, pasi ata janë imazhi i policisë, si dhe një urë lidhëse me komunitetin. Policimi në komunitet e ka sjellë policinë më pranë komunitetit, pasi inspektorët janë mjaft të kualifikuar dhe shihen pozitivisht nga komuniteti. Rritja e numrit të telefonatave është një tregues së imazhi i policisë dhe mendimi për ta ka ndryshuar pozitivisht. Në fakt, në Shkodër bashkëpunimi midis komunitetit dhe policisë ka rritur besimin e publikut tek policia. Grupet e krijuara të policimit në komunitet mund të përmirësojnë ligjin dhe rendin, si dhe sigurinë në komu-

nitet nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme. Pikërisht gjatë javës së intervistave në Shkodër (7 qershor 2013), departamenti i policisë me psikologët e shkollave organizuan një sërë aktivitete në 16 shkolla të qarkut mbi rritjen e ndërgjegjësimit dhe ndikimet e përdorimit të drogave dhe alkoolit. Ky aktivitet u pasqyrua gjerësisht në media. Aktorët kryesorë me influencë në policimin në komunitet kanë qenë seksioni i arsimit, OJF, si “Gruaja për Gruan”, Qyteti Kreativ dhe Komuniteti Rom.

Disa nga çështjet kryesore të raportuara në Shkodër përfshijnë ndotjen akustike nga klubet e natës dhe kultivimi i cannabis sativa. Çështja e ndotjes akustike besohet të jetë zgjidhur nëpërmjet partneritetit dhe angazhimit aktiv të autoriteteve vendore. Pavarësisht se ekziston një task forcë për kontrollin e ndotjes akustike, kërkohet një bashkëpunim më i mirë midis komunitetit, autoriteteve vendore dhe policisë.

#### *2.4. Përmbledhje e Sugjerimeve të të Intervistuarve*

Njihet gjerësisht fakti se imazhi i policisë para komunitetit është shumë i rëndësishëm për besimin dhe bashkëpunimin. Në këtë aspekt, ka vend për më shumë besim ndaj policisë. Është e domosdoshme që ngjarjet e raportuara nga qytetarët e pa-përfshirë të adresohen nga policia menjëherë dhe në mënyrë profesionale. Inspektorët duhet të jenë më afër komunitetit, shkollave dhe bizneseve për t’u informuar me problemet e tyre ditore, në mënyrë që të parandalojnë konflikte të mundshme. Nga ana tjetër, edhe komuniteti duhet të jetë aktiv dhe pjesëmarrës dhe jo vetëm të presë nga policia. Komunitetet duhet të jenë më bashkëpunuese, të qartësojnë atë që presin nga policia dhe të konsiderojnë policinë si partnerë në jetën e tyre të përditshme.

Policimi në komunitet duhet të shihet si një shërbim që duhet të funksionojë mirë. Policia është ende disi larg komunitetit dhe duhet të ushqehet një klimë e besimit të ndërsjellë. Me qëllim që të gjitha grupet të kenë një zë të fuqishëm në policimin në komunitet, puna e tyre duhet që të pasqyrohet siç duhet në media. Një ndërgjegjësim më i madh dhe ndarja dhe shkëmbimi i informacionit midis aktorëve të policimit në komunitet është gjithashtu i domosdoshëm.

Ndërkohë që në disa raste ekziston një manual për dhunën në familje, ai konsiderohet me tepër teorik dhe jo shumë praktik. Manuali duhet të shoqërohet me udhëzime konkrete. Në vazhdim, instrumentet për përmirësimin e partneritetit duhet të rishikohen dhe ky proces duhet të iniciohet nga vetë policia. Për shembull, policia bashkiake dështon në trajtimin e sjelljeve anti-sociale. Ka vende, si Spanja dhe Franca, të cilat kanë një sistem eficient, por në Shqipëri nuk është kështu. Alternativa të ndrysh-

me mund të zbatohen në lidhje me çështjet e të rinjve, jo të gjitha mund të jenë të suksesshme, por ky duhet të jetë një proces në vazhdimësi dhe të rishikohet sipas rastit.

Policia e shtetit duhet të përmirësojë performancën e saj dhe përzgjedhjen e stafit. Rinovimi i strukturave, rritja e kapaciteteve dhe kualifikime profesionale me të mira së bashku me koordinimin e punës dhe bashkëpunimin me struktura dhe organe të tjera të shtetit konsiderohen, si disa nga elementët thelbësorë për përmirësimin e policimit në komunitet.

Gjithashtu, sugjerohet edhe përmirësimi i partneritetit, duke e zgjeruar rrethin e aktorëve të policimit në komunitet. Motivimi dhe nxitja financiare për stafin u vu në dukje si një masë e mundshme e përmirësimit të partneritetit.

Vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e punës varet edhe nga një përcaktim i qartë i roleve, treguesve, si dhe matja e tyre. Përgjegjshmëria individuale dhe institucionale del në pah si një dimension që vetëm do të ndihmonte në përmirësimin e policimit në komunitet.

Në një dimension tjetër, konceptet e bashkëpunimit midis komunitetit dhe policisë duhet të jenë pjesë e programit shkollor. Kjo do të çojë në qëndrime bashkëpunuese, nëpërmjet kuptimit me të mirë nga ana e qytetarëve se çështjet e sigurisë së tyre trajtohen me mirë me bashkëpunim të komunitetit me policinë. Edukata qytetare duhet të përmirësohet në mënyrë graduale dhe të mundësojë ndryshimin e mentalitetit dhe sjelljes.

Përmirësimi i imazhit të policisë në shërbim të komunitetit duhet të jetë prioriteti kryesor. Një nivel më i lartë edukimi i forcës së policisë dhe veçanërisht i inspektorëve të lagjes është identifikuar si i rëndësishëm. Ata janë, tashmë, të familjarizuar me komunitetin e nxënësve dhe mësuesve dhe konsiderohen si anëtarë të afërt të shkollës. Policia duhet të marrë pjesë në mbledhjet e këshillit pedagogjik të shkollës, në mënyrë që shkolla të përfshihet më shumë në luftën kundër përdorimit të drogave. Oficerët e policisë duhet të jenë më prezent gjatë pushimit të orëve të mësimin në shkolla.

### 3. Plan veprim i propozuar për zbatimin e mekanizmit të partneritetit

Nr. Ref	Aktiviteti	Koha e fillimit	Koha e përfundimit	Përgjegjësia	Komente
<b>B 1</b>	Nisja e e procesit të hartimit të një dokumenti ligjor mbi sjelljen anti - shoqërore	Janar 2014	Fundi i Shkurtit 2014	Ekipi i Projektit dhe PSH do të shërbejë në rolin si drejtues/mentor - Policia e Shtetit do të jetë përgjegjës për kryerjen e punës	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi i nevojës për ligj të ri.</li> <li>2. Shqyrtimi i modeleve për hartimin e një ligji.</li> <li>3. Hartimi i një drafti për rishikim.</li> <li>4. Paraqitja pranë organit përkatës legjislativ.</li> </ol>
<b>B 1.1</b>	Të kryhen një sërë takimesh mes ekspertësh për të shqyrtuar çështjen e legjislacionit në lidhje me rregullimin ligjor të sjelljes anti-shoqërore;	Janar 2014	Mars 2014	Ekipi i Projektit dhe PSH do të promovojë dhe mbështesë takimet e kërkuara. Takimet do të kryesohen nga PSH	Formimi i një komitet ekspertësh (përfaqësues PSH-Prokurori-Gjykatësi-Parlamenti) Konfirmimi i nevojës për ligj të ri. Kryerja e hulumtimeve mbi ligjet e vendet e tjera që mund të shërbejnë si model. Hartimi i një drafti. Kjo do të realizohet nëpërmjet një seri takimesh.
<b>B 1.2</b>	Workshop mbi rezultatet e takimeve	Mesi i Marsit 2014		Ekipi i Projektit dhe PSH do të mbështesë workshop-in. Takimi do të kryesohet nga PSH	Takim një ditor, ku komiteti paraqet punën e tij për rishikimin final dhe komentet shitesë nga ekspertë e anëtarë të shoqërisë civile. Sesioni i fundit do të përfshijë krijimin e draftit final.
<b>B 1.4</b>	Hartimi i draft- ligjit	Fundi i Marsit 2014	Fillimi i Qershorit 2014		Komiteti Ekspertëve do të marrë në konsideratë kontributin e workshop-it dhe të krijojë versionin draft përfundimtar të legjislacionit të propozuar

B 1.5	Prezantimi i draft-ligjit dhe aktiviteteteve të lobimit.	Pas pushimit veror të Kuvendit	Fund i 2014	PSH	
B 2	<b>Miratimi i një plan veprimi kombëtar të integruar (PIK) për policimin në komunitet (planet e veprimit të DPQs do të jenë kapitujt e PIK)</b>	Mesi i Janarit			Ekipi i Projektit do të këshillojë dhe udhëheqë zyrtarët e duhur të PSH në përgatitjen, miratimin dhe zbatimin e planit.
B 2.1	<b>Vlerësimi i planeve aktuale të DPQs për PK;</b>	Janar 2014	Shkurt 2014	Ekipi i projektit do të trajtojë dhe këshillojë PSH	Ekipi i projektit do të punojë me PSH në organizimin e një sërë takimesh për të vlerësuar planet DPQ-s
B 2.2	<b>Hartimi i një metodologjie të unifikuar për hartimin e planeve të policimit në komunitet nga drejtoritë e policisë në qarqe (DPQ);</b>	Janar 2014	Shkurt 2014	Ekipi i projektit do të trajtojë dhe këshillojë PSH	Njëkohësisht, me B 2.1 - takimet do të përfshijnë diskutime mbi zhvillimin e një metodologjie efektive.
B 2.3	<b>Trajnimi i pikave të kontaktit në qarqe dhe strukturës koordinuese në DPP;</b>	Mars 2014	Fund Prilli 2014	Ekipi i projektit do të mbështesë PSH në ofrimin e trajnimit të pikave të kontaktit dhe të ndihmojë me aktivitetet koordinuese	Ekipi i projektit do të punojë me PSH në identifikimin e trajnerëve (janar 2014). Brenda mundësive, trajnerët e propozuar do të marrin pjesë në disa nga takimet e vlerësimit / metodologjisë. Kjo kushtëzohet nga Policia e Shtetit në emërimin e pikave fokale në DPQ.

B 2.4	<b>Miratimi i PIK dhe trajnimi në terren</b>	Maj 2014		Ekipi i projekti do të mbështesë PSH në arritjen e miratimit formal të planit dhe do të ndihmojë në organizimin e trajnimit në terren	Ekipi i projektit do të monitorojë sa më shumë aktivitete të trajnimit në terren që të jetë e mundur.
B 3	<b>Përmirësimi i bashkëveprimit mes Policisë së Shtetit dhe Komunitetit.</b>				
B 3.1	<b>Hartimi i një Manuali për Krijimin dhe Funksonimin e Forumeve Komunitare;</b>	Janar	Fund Shkurti	Ekipi i projektit dhe Konsulenti me pjesëmarrjen e PSH	Një konsulent privat, nën drejtimin e Policisë së Shtetit dhe Ekipit të projektit, do të paraqesë një manual udhëzues për të ndihmuar PSH në krijimin e forumeve të komunitetit. Kjo do të përfshijë hulumtimin e praktikave ekzistuese më të mira. Drafti do të shqyrtohet nga PSH dhe ekipi i projektit. Udhëzuesi do të përfshihet në trajnimin në terren.
B 3.2	Lehtësimi i partneritetit mes të Policisë së Shtetit dhe shoqërisë civile / OJF-të, për të formuar komitete ad hoc të sigurisë për të adresuar çështje të veçanta të nivelit të lartë (p.sh. siguria në rrugë). Zhvillimi i forumeve hibride ( <i>komunitare dhe ligjore</i> ) të ngritur nga ligjet për arsimin universitar, arsimin parauniversitar dhe për bashkëpronësinë në banesa.	cqT	Në vazhdim	Ekipi i projektit dhe PSH	Ekipi i projekti do të promovojë Grupin e Përbashkët të punës, për të zhvilluar strategjinë dhe për të pëmbushur këtë objektiv. Ekipi i projektit do të japë mbështetje PSH, duke organizuar takime me palët relevante për të krijuar komitetet e sigurisë dhe forumet.

<b>B 4</b>	Përmirësimi i sallës së pritjeve të publikut në stacionet policore dhe DPQ-t				
<b>B 4.1</b>	Ekipi i projektit pasi merr miratimet e nevojshme, do të hartojë udhëzime për të facilituar një konkurrencë të DPQ-ve për të siguruar mbështetje për përmirësimin e një hapësire të pritjes për publikun për të bashkëvepruar me policinë. Kjo do të jetë e ngjashme me qasjen e përdorur në Skemën e Granteve të Vogla.	Janar 2014	Fund Marsi 2014	Ekipi i projektit	Ekipi i projektit do të punojë ngushtë me zyrtarët e duhur të Policisë së Shtetit për të ofruar asistencë në hartimin e projekt-propozimeve.
<b>B 4.2</b>	Prokurimi i punimeve për rregullimin e ambienteve;	Mars 2014	Qershor 2014	Ekipi i projektit	
<b>B 4.3</b>	Hartimi i një urdhri të Drejtorit të Përgjithshëm, që do të zyrtarizojë formatin dhe standardet teknike për çdo rinovim të ambienteve pritëse në të ardhmen;	Qershor 2014	Korrik 2014	Ekipi i Projektit - PSH	Pas një rishikimi të efektshmërisë së facilitetve të rinovuara do të organizohet një takim me ekipin e projektit dhe PSH për të identifikuar praktikatat e mira. Do të krijohet një raport për rishikim nga Zyra drejtorëve të përgjithshëm.
<b>B 4.4</b>	Hartimi i një moduli i dhe një manuali trajnimi i oficerëve të policisë mbi teknikat dhe praktikën e komunikimit me publikun;	Fillimi Janarit 2014	Fund Marsi 2014	Ekipi i Projektit - Konsulenti - PSH	Ky manual do të përdoret gjatë trajnimit në terren, së bashku me manualin për krijimin e forumeve të komunitetit.
<b>B 4.5</b>	<b>Trajnimi i oficerëve të policisë mbi teknikat dhe praktikatat e komunikimit me publikun</b>	Fundi Marsit 2014	vazhdim	Ekipi i Projektit - Konsulenti - PSH	Një konsulent do të asistojë PSH në ofrimin e trajnimeve të specializuara për zyrtarët e trajnimit në terren (trajnim trajnerësh)



<b>B 5</b>	<b>Krijimi i një komiteti koordinues për parandalimin e krimit në përputhje me modelin e mekanizmit koordinues për parandalimin e dhunës në familje.</b>				
<b>B 5.1</b>	Vlerësimi i efektivitetit të mekanizmit koordinues për parandalimin e dhunës në familje.	Vjeshtë 2014	Dimër 2014	Ekipi i Projektit	Ky aktivitet do të fillojë ofrimin të trajnimit në terren të Manualit mbi dhunën në familje. Ekipi I projektit me PSH do të kryejnë vlerësime periodike për të vlerësuar nivelin e bashkëpunimit.
<b>B 5.2</b>	Hartimi i një dokumenti teknik përfshirë propozimin mbi subjektin në fjalë, pjesëmarrja, procedurat e veprimit dhe vendim-marrjes së komitetit koordinues për parandalimin e krimit;	Vjeshtë 2014	Dimër 2014	Ekipi i Projektit dhe PSH	Ekipi i projektit do të trajnojë dhe udhëheqë zyrtarët e përshtatshëm të PSH dhe shoqërinë civile, të cilët janë pjesë në përmbushjen e këtij objekti. Ekipi i projektit do të lehtësojë një sërë takimesh për të krijuar dokumentin teknik. Ekipi i projektit dhe PSH do të konsiderojnë krijimin e një Komiteti “pilot” për të provuar efektivitetin e përgjithshëm.
<b>B 5.3</b>	Hartimi i një draft VKM për krijimin e komitetit koordinues për parandalimin e krimit.	Fundi i 2014		Ekipi i Projektit dhe PSH	Pas përvetësimit të mësimëve të nxjerra nga Komisioni Pilot, një sërë takimesh të ekspertëve (ekipi i projektit -PSH-OJF) do të përgatisin një draft VKM

#### 4. Tabelat kryesore të sondazhit

### Përmbledhje e Rezultateve të Sondazhit me Qytetarët

#### Seksioni I: Të dhëna të përgjithshme

Zona e qytetit ku zhvillohet intervista: **Qarku Tiranë**

##### 1.1. Gjinia

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	16	5,30%	4	1,04%	20	2,92%
Femër	145	48,01%	190	49,61%	335	48,91%
Mashkull	141	46,69%	189	49,35%	330	48,18%

##### 1.2. Arsimi

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	7	2,32%	10	2,61%	17	2,48%
Arsim i ulët	15	4,97%	89	23,24%	104	15,18%
Arsim i mesëm	138	45,70%	165	43,08%	303	44,23%
Arsim i lartë	142	47,02%	119	31,07%	261	38,10%

## Seksioni II: Siguria në komunitetin tuaj

### 2.1 Sa kohë keni që jetoni në këtë zonë të qytetit?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	0	0,00%	1	0,26%	1	0,15%
Më pak se 1 vit	15	4,97%	11	2,87%	26	3,80%
1-3 vjet	38	12,58%	14	3,66%	52	7,59%
3-5 vjet	52	17,22%	32	8,36%	84	12,26%
Më shumë se 5 vjet	197	65,23%	325	84,86%	522	76,20%

### 2.2 Siguria në komunitet

#### 2.2.1. Ndjeheni i/e sigurt në lagjen/komunitetin tuaj?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	2	0,66%	1	0,26%	3	0,44%
Gjithmonë	109	36,09%	158	41,25%	267	38,98%
Përgjithësisht	139	46,03%	147	38,38%	286	41,75%
Jam i pavendosur	31	10,26%	45	11,75%	76	11,09%
Asnjëherë	21	6,95%	32	8,36%	53	7,74%

### 2.2.2. Sa të sigurt ndiheni të qëndroni jashtë deri vonë?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	3	0,78%	4	0,58%
Gjithmonë	76	25,17%	92	24,02%	168	24,53%
Përgjithësisht	105	34,77%	133	34,73%	238	34,74%
Jam i pavendosur	54	17,88%	73	19,06%	127	18,54%
Asnjëherë	66	21,85%	82	21,41%	148	21,61%

### 2.2.3. Nëse në lagjen tuaj ka patrulla të vazhdueshme policie, ju ndjeheni më i/e sigurt?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	1	0,26%	2	0,29%
Gjithmonë	144	47,68%	155	40,47%	299	43,65%
Përgjithësisht	97	32,12%	151	39,43%	248	36,20%
Jam i pavendosur	24	7,95%	35	9,14%	59	8,61%
Asnjëherë	36	11,92%	41	10,70%	77	11,24%

### 2.3 Mesa jeni në dijeni, në lagjen tuaj sa shpesh kanë ndodhur ngjarjet e mëposhtme?

		Pa përgjigje	Kurrë	Ndonjëherë	Shpesh	Gjithmonë
1	Sulme ndaj personave	0,29%	41,02%	45,99%	11,53%	1,17%
2	Sulme ndaj të moshuarve	0,44%	69,05%	25,11%	5,40%	0%
3	Abuzime ndaj fëmijëve	0,29%	67,88%	26,28%	5,11%	0,44%
4	Vjedhje brenda familjes	0,15%	44,53%	42,77%	<b>10,95%</b>	1,61%
5	Dhunë brenda familjes	1,02%	38,54%	46,86%	<b>12,12%</b>	1,46%
6	Probleme të trafikimit dhe të drogës	0,44%	43,94%	37,08%	<b>16,20%</b>	2,34%
7	Përdorim të drogës	1,02%	28,76%	43,07%	<b>22,92%</b>	4,23%

8	Drejtim makine në gjendje të dehur	1,46%	19,12%	48,61%	<b>26,57%</b>	4,23%
9	Krime ndaj makinave (vjedhje kasetofonësh, pjesë të tjera të mjetit ose edhe vjedhje makine)	0,88%	33,87%	33,43%	<b>26,57%</b>	5,26%
10	Prishje e rendit publik	0,44%	31,82%	48,61%	<b>14,60%</b>	4,53%
11	Dehje kolektive	0,73%	52,55%	31,53%	<b>12,26%</b>	2,92%
12	Krime raciale/fetare	0,58%	87,45%	9,64%	1,61%	0,73%
13	Sulme seksuale	0,73%	75,62%	19,27%	3,65%	0,73%
14	Vjedhje në rrugë	0,58%	20,44%	49,93%	<b>24,38%</b>	4,67%
15	Vandalizma (graffiti)	2,77%	53,87%	28,76%	<b>11,09%</b>	3,50%
16	Krime homofobike	2,77%	80,15%	14,60%	2,04%	0,44%

#### 2.4 Përgjithësisht, përgjegjës të situatave të tilla janë?

	Nr	total
Persona të panjohur	547	79,85%
Miqtë tuaj	3	0,44%
Tjetër	25	3,65%
Persona të panjohur dhe të njohur	42	6,13%
Persona të njohur dhe miqtë tuaj	1	0,15%
Persona të panjohur dhe tjetër	1	0,15%

2.5 A e dini se cili është autoriteti që mund t'i drejtoheni, në rast se ndodh një nga ngjarjet e listuara ne seksionin 2.3, si (vjedhje, prishje e qetësisë publike, zënie ndërmjet dy ose më shumë personave)?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	1	0,26%	2	0,29%
Po	278	92,05%	339	88,51%	617	90,07%
Jo	23	7,62%	43	11,23%	66	9,64%

## 2.6 A keni kërkuar ndonjëherë ndihmën e policisë?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	5	1,66%	12	3,13%	17	2,48%
Po	65	21,52%	85	22,19%	150	21,90%
Jo	232	76,82%	286	74,67%	518	75,62%

### 2.6.1 Nëse po, cila ka qenë arsyeja që keni kërkuar ndihmën e policisë?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	215	71,19%	298	77,81%	513	74,89%
Kam qenë dëshmitar kur ka ndodhur një ngjarje	41	13,58%	37	9,66%	78	11,39%
Kam pësuar një ngjarje unë personalisht ose familja ime	22	7,28%	42	10,97%	64	9,34%
Tjetër	23	7,62%	6	1,57%	29	4,23%
Të dyja	1	0,33%	0	0,00%	1	0,15%

2.7 A ju ka rënë rasti të bëni një raportim në polici për ndonjë rast që ju ka afektuar direkt apo keni qenë dëshmitar?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	197	65,23%	307	80,16%	504	73,58%
Po	57	18,87%	64	16,71%	121	17,66%
Jo	48	15,89%	12	3,13%	60	8,76%

### 2.7.1 Nëse jo, cila ka qenë arsyeja që nuk e keni raportuar atë?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	135	44,70%	265	69,19%	400	58,39%
Nuk kam besim te policia	44	14,57%	36	9,40%	80	11,68%
Do ta zgjidhja vetë problemin	70	23,18%	30	7,83%	100	14,60%
Tjetër	51	16,89%	54	14,10%	105	15,33%
Të dyja	2	0,66%	0	0,00%	2	0,29%

### 2.8. A do t'ju pëlqente të përfshiheshit ju apo të afërmit tuaj në strukturat e policisë?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	2	0,66%	3	0,78%	5	0,73%
Po	103	34,11%	180	47,00%	283	41,31%
Jo	197	65,23%	200	52,22%	397	57,96%

## SEKSIONI III: BASHKËPUNIMI ME POLICINË

3.1 Nëse do të ngrihej një projekt për bashkëpunimin me policinë në lagjen tuaj, a do të dëshironit të përfshiheshit?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	1	0,26%	2	0,29%
Po	148	49,01%	202	52,74%	350	51,09%
Jo	83	27,48%	110	28,72%	193	28,18%
Nuk e di	70	23,18%	70	18,28%	140	20,44%

### 3.2 Jeni takuar ndonjëherë me policinë e lagjes tuaj për arsye informimi?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	2	0,52%	3	0,44%
Po	86	28,48%	122	31,85%	208	30,36%
Jo	215	71,19%	259	67,62%	474	69,20%

### 3.3 Njihni ndonjë efektiv policie të lagjes suaj si fytyrë apo si emër?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	2	0,52%	3	0,44%
Po	209	69,21%	252	65,80%	461	67,30%
Jo	92	30,46%	129	33,68%	221	32,26%

### 3.4 Si ndjeheni kur shikoni apo takoni një polic në lagjen tuaj?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	3	0,78%	4	0,58%
I sigurt	62	20,53%	88	22,98%	150	21,90%
I qetë	128	42,38%	142	37,08%	270	39,42%
Në ankth	6	1,99%	8	2,09%	14	2,04%
Indiferent	92	30,46%	115	30,03%	207	30,22%
Tjetër	11	3,64%	26	6,79%	37	5,40%
I sigurt dhe i qetë	2	0,66%	1	0,26%	3	0,44%



### 3.5 A e dini numrin e telefonit të policisë së rendit?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,003311	5	1,31%	6	0,88%
Po	217	0,718543	279	72,85%	496	72,41%
Jo	84	0,278146	99	25,85%	183	26,72%

### 3.6 E dini se ku është zyra më e afërt e policisë në zonës tuaj?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	3	0,78%	4	0,58%
Po	237	78,48%	290	75,72%	527	76,93%
Jo	64	21,19%	90	23,50%	154	22,48%

### 3.7 Sipas perceptimit tuaj, sa angazhohet policia për zgjidhjen e problemeve të qytetarëve?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	2	0,66%	5	1,31%	7	1,02%
Maksimalisht	12	3,97%	28	7,31%	40	5,84%
Shumë	55	18,21%	67	17,49%	122	17,81%
Disi	149	49,34%	160	41,78%	309	45,11%
Pak	57	18,87%	89	23,24%	146	21,31%
Aspak	27	8,94%	34	8,88%	61	8,91%

### 3.8 Sipas informacionit tuaj, sa shpesh bashkëpunon policia me qytetarët?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	1	0,33%	4	1,04%	5	0,73%
Gjithmonë	61	20,20%	85	22,19%	146	21,31%
Rrallë	196	64,90%	209	54,57%	405	59,12%
Asnjëherë	29	9,60%	54	14,10%	83	12,12%
Nuk e di	15	4,97%	31	8,09%	46	6,72%

### 3.9 Sa do ta cilësonit nivelin e respektit të qytetareve ndaj policisë?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	2	0,66%	4	1,04%	6	0,88%
Shumë të lartë	27	8,94%	53	13,84%	80	11,68%
Të lartë	76	25,17%	75	19,58%	151	22,04%
Mesatar	129	42,72%	145	37,86%	274	40,00%
Të ulët	68	22,52%	106	27,68%	174	25,40%

3.10 A ju është kërkuar ndonjëherë të jepni mendim për punën e policisë dhe problematikat që shqetësojnë komunitetin?

	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	8	2,65%	6	1,57%	14	2,04%
Po	56	18,54%	26	6,79%	82	11,97%
Jo	238	78,81%	351	91,64%	589	85,99%

### 3.11 A mendoni se mendimet dhe rekomandimet e qytetareve ndikojnë në punën e policisë?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	154	50,99%	316	82,51%	470	68,61%
Shumë	21	6,95%	20	5,22%	41	5,99%
Disi	64	21,19%	29	7,57%	93	13,58%
Pak	45	14,90%	12	3,13%	57	8,32%
Aspak	18	5,96%	6	1,57%	24	3,50%

### 3.12 A keni dijeni për shoqata apo organizime komuniteti për mbrojtjen nga krimi?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	6	1,99%	12	3,13%	18	2,63%
Po	71	23,51%	46	12,01%	117	17,08%
Jo	177	58,61%	278	72,58%	455	66,42%
Nuk e di	48	15,89%	47	12,27%	95	13,87%

### 3.13 Sipas jush, sa i rëndësishëm është bashkëpunimi i komunitetit me policinë?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	4	1,32%	5	1,31%	9	1,31%
Shumë	249	82,45%	329	85,90%	578	84,38%
Disi	40	13,25%	46	12,01%	86	12,55%
Aspak	9	2,98%	3	0,78%	12	1,75%

### 3.14 A do të ishit të gatshëm të merrni pjesë në grupe komunitare për policimin në komunitet?

Përgjigje	15-34 vjeç		35-69 vjeç		Total	
	nr	%	nr	%	nr	%
Pa përgjigje	4	1,32%	5	1,31%	9	1,31%
Po	149	49,34%	195	50,91%	344	50,22%
Jo	72	23,84%	125	32,64%	197	28,76%
Nuk e di	77	25,50%	58	15,14%	135	19,71%

## 5. Rastet Studimore

Policimi i ri dhe modern bazohet në idenë që punonjësit e policisë dhe anëtarët e komunitetit punojnë së bashku, duke aplikuar mënyra të ndryshme të reja për të zgjidhur problemet që shqetësojnë komunitetin në lidhje me krimin apo aspekte të tjera sociale.

Janë përzgjedhur, në bashkëpunim me kontraktorin, dy raste studimore për policimin në komunitet, ai i Kosovës dhe i Kroacisë, si praktika të mira. Të dy rastet ofrojnë eksperiencë pozitive dhe mund të shërbejnë për përmirësimin e modelit të policimit në Shqipëri. Rasti i Kroacisë shpalos praktikën më të mirë të aktivitetëve në kuadër të policimit në komunitet, ndërkohë që rasti i Kosovës nxjerr në pah – ndoshta, dhe për vetë problematikën e Kosovës, përpjekjet legjislative, strategjike dhe operacionale për të siguruar një model sa më të mirë të policimit në komunitet. Është për t'u nënvizuar elementi i përbashkët i të dy shembujve – ai i ndryshimit të qasjes së policimit, duke e vënë theksin te parandalimi nëpërmjet partneritetit.

### *Rasti i Kroacisë*

Në Kroaci një qasje e re proaktive dhe parandaluese e modelit modern të policimit bazuar në komunitet, që mori jetë në vitin 2002 me hartimin e një dokumenti strategjik të titulluar “Plani i Veprimit”. Deri në atë kohë, qasja policore ishte kryesisht reaguese dhe represive. Pjesën më të madhe të burimeve policia e përdorte për t’iu përgjigjur telefonatave të qytetarëve, gjë e cila linte shumë pak kohë dhe energji për nismat e tyre, që kishin të bënin me parandalimin ose reduktimin e problemeve ekzistuese në komunitet.

Ky dokument strategjik përvijoi detyrat e policisë që përfshinin dhe përballjen me situata të ndryshme të problemeve në komunitet, për të cilat, jo detyrimisht, ekzistojnë dispozita penale. Si rrjedhojë, policia nuk kufizohet vetëm me Kodin Penal, por mund të kërkojë gjithashtu për burime të tjera të disponueshme dhe mund të angazhojë shërbime të tjera publike.

Në 2003 filloi projekti pilot “Policimi në Komunitet» dhe, në 2004, Ministri miratoi Udhëzimet e Programit të Ministrisë së Brendshme për qendrat rajonale për një periudhë 4 vjeçare 2004 – 2007. Në 2007, Strategjia e Veprimit për Policimin në Komunitet u riformulua, gjë që u pasua me Udhëzimet e Programit të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë për periudhën 2008 – 2011.

Prioritetet kryesore të përcaktuara kanë të bëjnë me përforcimin e modelit të policimit **në komunitet dhe përforcimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, edukimit dhe trajnimit. Nga ana tjetër, përmirësimi i nivelit të sigurisë, nëpërmjet bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar, veçanërisht gjatë sezonit turistik, së bashku me investime të mëtejshme në pajisje teknike**, u konsideruan gjithashtu si prioritetet.

Nga pikëpamja e burimeve njerëzore, dy poste të reja pune janë përcaktuar në strukturat e policisë. Punonjësi për policimin **në komunitet** “në të gjitha kategoritë e rajoneve policore dhe punonjësi i policisë për parandalimin” në disa prej rajoneve policore. Në të njëjtën kohë, u krijua dhe Departamenti për Parandalimin në Zyrën e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

Programi “Unë mundem nëse unë dua 1” adreson nxënës të klasës së katërt fillore, rreth 8000 nxënës në vit. Qëllimi është sensibilizimi i fëmijëve për të kontaktuar policinë, njohja me rolin mbrojtës të policisë dhe prezantimi i punonjësve të policisë si miqtë dhe mbështetësit e tyre. Ky program plotësohet nga “Unë mundem nëse dua 2”, **që ka në qendër** prindërit e studentëve, nxënës së klasës së gjashtë, rreth 4,000 prindër në vit. Qëllimi është adoptimi i një qëndrimi pozitiv ndaj problemit të krimit, i cili nuk është një problem ekskluziv i policisë, por i komunitetit të gjerë. Në këtë program punonjësit e policisë shpërndanë në takime me prindërit broshurat për përpjekjet e përbashkëta kundër drogës.

Një program tjetër, **që do të ishte me shumë vlerë dhe në Shqipëri**, është ai i sigurisë në trafik. Rreth 30,000 nxënës të klasës së shtatë dhe të tetë dhe të vitit të parë të shkollës së mesme ishin në objektivat e këtij programi, që synon edukimin e studentëve për rregullat e qarkullimit.

Vlerësimi i punës së kryer ka nxjerrë në pah arritje pozitive të kësaj qasjeje proaktive **të policimit në komunitet. Një** komunikim dhe bashkëpunim më i mirë vihet re si me komunitetin vendor, ashtu dhe autoritetet vendore. Shënohet një rritje e besimit të qytetarëve në polici dhe një përfshirje e policisë në zgjidhjen e problemeve të qytetarëve. Në mënyrë specifike, numri i aktiviteteve policore parandaluese

ka shënuar rritje, ndërkohë që ato represive kanë shënuar ulje. Për më tepër, është vënë re dhe një rritje e kënaqshmërisë së punonjësve të policisë për punën e tyre.

### *Rasti i Kosovës*

Policia e Kosovës u krijua në kuadër të Shtyllës së parë (Justice and Police) të UNMIK pas përfundimit të luftës. Me prioritet ruajtjen e rendit publik, menaxhimin e turmave apo protestave, koncepti i sigurisë njerëzore nuk kishte vëmendjen e duhur. Për më tepër, dhe një lloj konfuzioni u vu re si pasojë e modeleve dhe praktikave të ndryshme të ndjekura nga pjesëmarrësit e forcës ndërkombëtare të policisë që vinin nga 40 vende të ndryshme.

Në vitin 2002, pas një lloj konsolidimi, doli natyrshëm dhe nevoja për një vëmendje ndaj kërkesave të qytetarëve për një cilësi më të mirë të sigurisë njerëzore. Ky ishte momenti që shënoi themelimin e njësisë së policimit në bashkësi, e cila kishte një punonjës policie në rolin e koordinatorit. Gjithsesi, u vu re që zbatimi i aktiviteteve policore në terren nuk përkonte me realitetin dhe nevojat e komunitetit e, si pasojë, u krijuan ekipet vepruese për sigurinë në bashkësi dhe projektet e *policit të fshatit* për identifikimin dhe zgjidhjen më të mirë të problemeve në komunitet.

Me mbështetjen e organizmave ndërkombëtare, u krijuan Ekipet e Qytetarëve Vullnetarë së bashku me Komitetet Lokale për Sigurinë në Bashkësi. Këto të fundit sanksionohen nga Ligji për Policinë dhe krijohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës pas rekomandimit të shefit të policisë vendore. Ndonëse në fillim këto komitete qenë të fokusuara në ato zona ku ka pasur popullatë të përzier, me qëllimin kryesor krijimin e besimit ndër etnik, me kalimin e kohës, u ndje nevoja e themelimit të tyre në zona problematike.

Me anë të një udhëzimi administrativ në vitin 2005, u themeluan Këshillat Komunale të Sigurisë në Bashkësi. Këto Këshilla identifikojnë çështjet në aspektin e sigurisë, analizojnë këto probleme dhe natyrisht identifikojnë modalitetet për gjetjen e zgjedhjeve, të cilat janë të pranueshme nga komuniteti. Ato kryesohen nga Kryetari i Komunës dhe në përbërje kanë Komandantin e Stacionit policor, përfaqësuesin e Forcave të Sigurisë së Kosovës, komunitetet fetare, Drejtoritë Arsimore, shoqërinë civile, drejtuesit e ekipeve dhe komiteteve të lartpërmendura, përfaqësuesi i të drejtave të njeriut në nivel komunal, si edhe mediat lokale.

Duke qenë se janë të mirë pozicionuara për njohjen e problemeve të komunitetit, këto këshilla hartojnë planet e veprimit, që më pas vijnë me projekte që realizohen në partneritet. Roli i Komandantit të stacioneve policore është vendimtar, pasi raporton për problemet e sigurisë komunitare dhe

i kthen ato në prioritete të punës së policisë. Përmes pjesëmarrjes aktive në takime, policia rrit besueshmërinë e saj si në zbatimin e ligjit.

Një qasje e re e punës, për sa i përket policimit në komunitet, shënohet me miratimin e Planit Zhvillimor Strategjik 2011-2015 të Policisë së Kosovës, që i konsideron të gjithë zyrtarët e policisë si pjesë e policimit në komunitet. Kjo qasje e sjell policinë shumë më afër qytetarëve dhe synohet parandalimi i krimit nëpërmjet një policie proaktive, efikase dhe efektive.

Qeveria e Kosovës ka miratuar strategjinë kombëtare për Siguri në Bashkësi. Plani i saj i veprimit 2011-2016 siguron një bashkërendim me strategjitë e tjera, si edhe mundëson krijimin e partneriteteve dhe zbatimin e masave në nivel lokal. Një ndër elementet më të rëndësishme të kësaj strategjie është inkuadrimi i komuniteteve të ndryshme në forumet e sigurisë, duke stimuluar pjesëmarrjen civile në forma vullnetare. Gjithashtu, interesant është dhe adresimi i situatave komplekse të sigurisë, si mbrojtja e pronës private e publike, mungesa e aksesit në shërbime shëndetësore, mbrojtja e pyjeve, trafiku rrugor dhe siguria në shkolla.

Kjo lloj qasjeje godet konceptin tradicional dhe bindjen se është policia ajo që duhet të kujdeset e vetme për sigurinë dhe mundëson që përfshirja e qytetarëve në planifikim dhe vendimmarrje të krijojë një ambient të sigurt për të gjithë qytetarët, duke rritur kështu edhe përgjegjshmërinë e palëve nëpërmjet këtij ndërveprimi.

Në Prill 2012, u aprovua gjithashtu strategjia e Policimit në Bashkësi, e cila synon ndërtimin e partneriteteve dhe marrjen e përgjegjësi nga të gjithë aktorët. Kjo strategji bazohet mbi një sërë strategjish të tjera, që kanë të bëjnë me policimin e udhëhequr nga informacioni, parandalimin e krimit, luftën kundër krimit të organizuar, luftën kundër drogës apo strategjinë e migrimit. Objektivi i strategjisë së Policimit në Bashkësi është dhe ndryshimi i mentalitetit të policisë së Kosovës dhe policimi i orientuar nga zgjidhja e problemit. Në zbatim të kësaj strategjie janë harmonizuar procedurat standarde operative dhe ndërveprimi me strategjitë e tjera është aprovuar struktura organizative e policisë dhe i është kushtuar vëmendje proceseve të rrjedhjes së informacionit nëpërmjet aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe standardizimit të formave të vlerësimit të performancës së punonjësve të policisë.

Me gjithë progreset legislative dhe institucionale, ka ende sfida të ndryshme që kryesisht kanë të bëjnë me ndryshimin e kulturës policore dhe mentalitetit të komunitetit. Nga pikëpamja praktike, moshja e personelit policor (mbi 42 vjeç) dhe shërbimet jo-policore të policisë përkundrejt agjencive të tjera shtetërore, së bashku me vështirësitë financiare, konsiderohen si sfida të tjera që ndikojnë në suksesin e policimit në komunitet.